



Leave
No One
Behind

VLERËSIMI I NEVOJËS PËR SHËRBIME SHOQËRORE NË 12 QARQET E SHQIPËRISË

Maj 2019

Ky dokument është përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror me ekspertizën dhe asistencën teknike të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetet pas" (LNB), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të UNDP në Shqipëri.

Tiranë, Maj 2019

Përgatitur nga:

Prof. Asoc. Dr. Arlinda Ymeraj

Nën drejtimin e:

Lida Leskaj *Zëvendësdrejtoreshë e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror*

Ndihmuan:

Ermelinda Jankishta *Specialiste e shërbimeve shoqërore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror*

Ermira Gjata *Specialiste e shërbimeve shoqërore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror*

Arkida Hysenaj *Specialiste e shërbimeve shoqërore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror*

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Përmbledhje	5
2. Përkufizime të përdorura dhe Shkurtesa dhe Kufizime të vlerësimit	8
2.1 Përkufizime	8
2.2 Shkurtesa	8
2.3 Kufizime të vlerësimit	8
3. Lista e tabelave dhe figurave	9
4. Vlerësimi i nevojës për shërbime shoqërore në kuadër të Projektit “Askush të mos mbetet pas” (Leave No One Behind)	11
5. Shërbimet shoqërore/ instrument i përfshirjes sociale të grupeve në nevojë	12
6. Analiza e situatës së shërbimeve shoqërore	13
6.1 Dimensioi 1 “Shërbimet shoqërore të ofruara në Shqipëri sipas qarqeve dhe bashkive” (Oferta e shërbimeve shoqërore)	13
6.2 Dimensioi 2 “Përfituesit e shërbimeve shoqërore sipas qarqeve dhe bashkive” (Kërkesa për shërbime shoqërore)	22
6.3 Dimensioi 3 “Shpërndarja e diferencuar e shërbimeve shoqërore”	25
7. Vlerësim i nevojës për shërbime shoqërore në nivel bashkie	30
7.1 Bashkitë e Qarkut Tiranë	30
7.2 Bashkitë e Qarkut Durrës	33
7.3 Bashkitë e Qarkut Gjirokastrë	35
7.4 Bashkitë e Qarkut Lezhë	38
7.5 Bashkitë e Qarkut Berat	40
7.6 Bashkitë e Qarkut Dibër	43
7.7 Bashkitë e Qarkut Elbasan	45
7.8 Bashkitë e Qarkut Kukës	47
7.9 Bashkitë e Qarkut Korçë	49
7.10 Bashkitë e Qarkut Vlorë	51
7.11 Bashkitë e Qarkut Fier	54
7.12 Bashkitë e Qarkut Shkodër	56
8. Vlerësime përfundimtare:	59
8.1 Në lidhje me ofertën e shërbimeve shoqërore	59
8.2 Në lidhje me shpërndarjen e diferencuar të shërbimeve shoqërore	59
8.3 Në lidhje me kërkesën për shërbime shoqërore	60

9. Rekomandime	61
9.1 Në lidhje me përmirësimin e sistemit ekzistues të shërbimeve shoqërore	61
9.2 Ndërtimi i një metodologjie të qëndrueshme dhe shkencore për të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nevojën për shërbime shoqërore	62
9.3 ShSSH-planifikues, rregullator dhe udhëzues i krijimit, administrimit dhe shpërndarjes së shërbimeve shoqërore në bashki	65
Shtojcë: Hartat e shërbimeve për 12 qarqet	67

1

PËRMBLEDHJE

Raporti “Vlerësimi i Nevojës për Shërbimet Shoqërore” udhëhiqet nga kërkesa për të analizuar informacionin ekzistues dhe të dhënat administrative, që pasqyrojnë shërbimet shoqërore në Shqipëri si edhe përfituesit e tyre, me qëllim vlerësimin e nevojës për këto shërbime, për të orientuar procesin e hartimit të politikave efektive të kujdesit shoqëror në nivel qendror e lokal, e më tej, të politikave të përfshirjes shoqërore.

Ky raport është përgatitur mbi bazën dhe duke përdorur të dhënat e pasura e të larmishme të mbledhura për herë të parë nga Shërbimi Social Shtetëror nëpërmjet burimeve të të dhënave administrative, si edhe në raportimet e zyrave rajonale të ShSSH-së, të cilat mundësuan:

- Të dhëna mbi shërbimet shoqërore, si edhe shpërndarjen e tyre.
- Të dhëna mbi grupet përfituese të shërbimeve shoqërore.
- Të dhëna mbi ofruesit e shërbimeve shoqërore.
- Të dhëna mbi nevojën për shërbime.

Megjithatë në përputhje me kërkesën e ShSSH-së për një analizë efektive dhe shumë dimensionale, u përdorën dhe u analizuan edhe burime të tjera, si:

- Analiza e legjisllacionit në fuqi.
- Studime dhe vlerësime të ShSSH-së, UNDP-së si edhe organizatave të tjera, të cilat kanë trajtuar këtë tematikë (sidomos në analizën e informacionit për Bashkitë Tiranë dhe Durrës).
- Planet sociale të bashkive, në ato bashki në të cilat këto plane janë përgatitur.

Të dhënat dhe informacionet e siguruar nga ShSSH dhe të pasuruar me të dhënat mbi strukturën demografike dhe popullsinë e Shqipërisë sipas bashkive, u përpunuan në përputhje me një kuadër metodologjik të përgatitur për këtë qëllim, i cili mbështetet në analizën e krahasuar dhe të kryqëzuar të informacionit dhe të dhënave administrative, për të vlerësuar nevojën për shërbime shoqërore, sipas tre dimensioneve themelore, përkatësisht:

Dimensioni 1: Oferta e shërbimeve shoqërore.

Dimensioni 2: Kërkesa për shërbime shoqërore.

Dimensioni 3: Shpërndarja e diferencuar e shërbimeve shoqërore.

Analiza e përgjithshme e informacionit ekzistues mbi shërbimet shoqërore në Shqipëri dhe përfituesit e tyre, tregoi qartësisht se shërbimet shoqërore janë zhvilluar, ndërsa cilësia e tyre është përmirësuar. Në përputhje me legjisllacionin në fuqi, Shërbimi Social Shtetëror, si institucioni përgjegjës monitoron me kujdes zbatimin e standardeve të shërbimeve, për të garantuar kujdesin cilësor për qytetarët dhe grupet në nevojë.

Kjo analizë sjell disa risi, siç vijojnë:

- Duke konsideruar treguesit e prodhuar këtu si vlera fillestare të nevojës dhe shpërndarjes së shërbimeve shoqërore, shërben për të krahasuar në aspektin kohor, dhe vlerësuar shkallën e zhvillimit të shërbimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

- Siguron një instrument për mbledhjen e unifikuar të të dhënave si edhe analizën e tyre për të orientuar investimet e përgjithshme për ndërtimin e shërbimeve të reja në nivel bashkie dhe qarku.
- Lehtëson ndërtimin e hartave të paraqitjes së shërbimeve për çdo qark dhe në nivel kombëtar.

Analiza e thelluar e informacionit, në përputhje me metodologjinë e zbatuar, në lidhje me vlerësimin e **“Ofertës”** për shërbime shoqërore, konstatoi se:

- Shërbimet shoqërore publike ofrohen në 30 qendra rezidenciale dhe 119 qendra komunitare/ditore, ndërsa shërbimet shoqërore jopublike ofrohen nga OJF ose organizata fetare në 86 qendra komunitare/ditore dhe 41 qendra rezidenciale, gjithsej në 276 qendra shërbimesh të llojeve të ndryshme.
- Shërbimet për fëmijë zënë peshën kryesore në numrin e përgjithshëm të shërbimeve, rreth 27%; Shërbimet për individë me AK dhe ato për individë në nevojë zënë përkatësisht nga 25%; Shërbimet për të moshuar rreth 18%, ndërsa shërbimet për gra në nevojë janë shumë të pakta, rreth 5% të numrit të përgjithshëm të shërbimeve.
- Qendrat jopublike sigurojnë rreth 46% të shërbimeve shoqërore, përkundrajt 54% të totalit që sigurohen nga qendrat publike, ndërsa qendrat komunitare/ditore sigurojnë rreth 74% të shërbimeve shoqërore përkundrajt 26% që sigurohen nga qendrat rezidenciale.
- Rreth 31% e shërbimeve shoqërore janë të përqendruara në Qarkun e Tiranës, ndërsa numri më i vogël i shërbimeve (0,8%) ofrohet në Qarkun e Kukësit.
- 34% e bashkive të vendit (21 bashki) nuk ofrojnë asnjë shërbim. Nga këto, 43% janë bashki me popullsi mbi 20 000 banorë. Vetëm 7 bashki ose 9% e bashkive ofrojnë të gjitha shërbimet. 38 bashki ose 62% e të gjitha bashkive të vendit nuk kanë shërbime për të moshuar, 43 bashki ose 71% e tyre nuk kanë shërbime për fëmijë, 37 bashki ose 61% e bashkive nuk ofrojnë shërbime për individë me aftësi të kufizuara dhe 39 bashki ose 64% e tyre nuk ofrojnë shërbime për individë në nevojë.
- Analiza e shërbimeve shoqërore sipas llojit, tregon se nga shërbimet që përcakton ligji, shërbimet parashoqërore, shërbimet e specializuara, shërbimet e këshillimit me telefon si edhe ato online, nuk ofrohen (shih tabelën 4).

Analiza e thelluar e informacionit, në përputhje me metodologjinë e zbatuar, në lidhje me vlerësimin e **“Kërkesës”** për shërbime shoqërore, konstatoi se:

- Vetëm 5 (ose 50%) nga 10 grupet e përcaktuara në ligj mund të përdorin shërbimet e destinuar për mbrojtjen dhe ri/integrimin shoqëror të tyre. Sipas ligjit (shih tabelën 4), përfitues të shërbimeve shoqërore duhet të jenë: Personat me aftësi të kufizuara, Fëmijët jashtë kujdesit prindëror, Të moshuarit, Viktimat e dhunës së trafikimit, Individët me probleme të veçanta si droga e alkooli, Individët me probleme të tjera sociale, Vajzat shtatzëna, Prindërit e vetëm të fëmijëve deri 1 vjeç, Të miturit në konflikt me ligjin, si edhe “Të rinjtë në konflikt me ligjin”. Nga këto grupe, vetëm “Personat me aftësi të kufizuara”, “Fëmijët jashtë kujdesit prindëror”, “Të moshuarit”, “Viktimat e dhunës e trafikimit”, “Individët me probleme të veçanta si droga e alkooli”, dhe në raste shumë të veçanta, familjet me probleme ekonomike e sociale, përfitojnë shërbime shoqërore.
- Numri më i madh i përfituesve të shërbimeve shoqërore është në Qarkun e Tiranës (24%), i pasuar nga Qarku i Fierit, 12%.
- Fëmijët janë përfituesit kryesorë të shërbimeve shoqërore në Qarqet Shkodër, Durrës dhe Tiranë; të moshuarit dominojnë si kategori përfituese në Qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë, individët me nevoja të veçanta janë përfituesit kryesorë të shërbimeve në Qarqet Fier, Korçë, Elbasan, Lezhë dhe Berat. Ndonëse individët me aftësi të kufizuara janë përfitues të shërbimeve shoqërore në çdo qark

të vendit, në asnjë qark ata nuk janë grupi kryesor përfitues.

- Pamjaftueshmëria e informacionit të dhënë në aspektin cilësor, kufizon mundësinë e analizës të “Kërkesës/Nevojës” për shërbime shoqërore, e cila deri diku plotësohet nëpërmjet ndërtimit të dy treguesve thelbësorë, indirektë, përkatësisht “Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim” dhe “Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve shoqërore në raport me grup-popullsinë”.

Analiza e thelluar e informacionit, në përputhje me metodologjinë e zbatuar, në lidhje me vlerësimin e “Shpërndarjes së diferencuar të shërbimeve shoqërore”, konstatoi se:

- Ndërsa të moshuarit e Korçës, kanë më shumë mundësi të përdorin shërbimet në qarkun e tyre (Numri mesatar i të moshuarve për një shërbim është 4,415), për të moshuarit në Qarqet Vlorë, Lezhë dhe Fier, kjo mundësi është tejet e kufizuar (Numri mesatar i të moshuarve për një shërbim është përkatësisht 12,171-Vlorë, 15,239-Lezhë dhe 37,453-Fier).
- Mundësia e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror në Qarqet e Dibrës, Fierit dhe Kukësit për të përfituar shërbime shoqërore, është tërësisht e mohuar, për shkak të mungesës së plotë të tyre, në dallim nga fëmijët e Tiranës, të cilët kanë shumë mundësi të përdorin shërbimet në qarkun e tyre (Numri mesatar i fëmijëve për një shërbim në Tiranë është 4,319).
- Individët me aftësi të kufizuara të Qarkut Dibër, nuk kanë asnjë mundësi që të përdorin shërbime shoqërore, në dallim nga individët me aftësi të kufizuara në Qarqet e Korçës, Gjirokastrës dhe Vlorës, të cilët kanë lehtësi në përdorimin e shërbimeve në qarkun e tyre (Numri mesatar i individëve me AK për çdo shërbim është përkatësisht në Korçë-90, në Gjirokastrë-176 dhe në Vlorë-302).
- Pesha specifike e grupeve të përfituesve të shërbimeve shoqërore, përkatësisht e të moshuarve, fëmijëve jashtë kujdesit prindëror si edhe individëve me aftësi të kufizuara, luhatet ndërmjet 0,01 dhe 1% të grup-popullsisë, për shumicën e qarqeve të vendit.
- Pabarazi të theksuara evidentohen në përfitimin e shërbimeve për individë me aftësi të kufizuara, përkatësisht nga 0% e atyre që janë me AK në Qarkun e Dibrës, në 3,5% të individëve me AK në Qarkun e Durrësit.

Raporti përbëhet nga 8 seksione, përmbledhja si edhe baza e të dhënave. Seksioni 6, 7, 8 dhe 9 janë komponentët më thelbësorë të kësaj analize. Seksioni 6 analizon situatën e shërbimeve shoqërore ekzistuese në vend sipas tre dimensioneve të përshkruara më lart. Seksioni 7 përshkruan nevojën për shërbime në bashkitë e vendit. Seksioni 8 përmbledh vlerësime të përgjithshme, ndërsa seksioni 9 paraqit rekomandimet e detajuara, në tre drejtime themelore, që janë:

Drejtimi 1: Rritja e efektivitetit të politikave ekzistuese të kujdesit shoqëror nëpërmjet monitorimit të shërbimeve shoqërore ekzistuese dhe zbatimit të standardeve të cilësisë së tyre, duke ndikuar në institucionalizimin e ofertës për shërbime shoqërore.

Drejtimi 2: Ndërtimi i një metodologjie të qëndrueshme dhe shkencore për të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nevojën për shërbime shoqërore, duke ndikuar në këtë mënyrë në institucionalizimin e vlerësimit të kërkesës/nevojës, e cila duhet të udhëheqë zhvillimin e ofertës.

Drejtimi 3: Propozimi i skemës teknike për vlerësimin e nevojës për shërbime shoqërore si edhe hapat për realizimin e saj mbështetur në misionin e ShSSH-së.

Raportit i bashkëngjitet baza e plotë e të dhënave në nivel qarku dhe bashkie, mbi bazën e të cilës janë ndërtuar 12 harta të shërbimeve shoqërore në bazë qarku si edhe harta e shpërndarjes së shërbimeve në nivel kombëtar. Gjithashtu baza e të dhënave mund të shërbejë si model dhe njëkohësisht, si referencë për të ardhmen.

2

PËRKUFIZIME TË PËRDORURA DHE SHKURTESA DHE KUFIZIME TË VLERËSIMIT

2.1 Përkufizime:

Individë në nevojë: Individë në nevojë kritike, kryesisht ekonomike dhe në disa raste edhe sociale, si edhe individë me varësi nga alkooli apo droga.

Qendrat komunitare dhe ditore janë konsideruar të njëjta, meqenëse të gjitha shërbimet komunitare të ofruara, janë ditore.

2.2 Shkurtesa:

AK	Aftësi të kufizuara
P	Publike
JP	Jopublike
LNB	Leave no one behind (<i>Askush të mos mbetet pas</i>)
ShSSH	Shërbimi Social Shtetëror
NM	Numri mesatar
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
DRShSh	Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve Shoqërore
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
UNDP	United Nations Development Program (<i>Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim</i>)

2.3 Kufizime të vlerësimit:

Mospërputhja e të dhënave të ShSSH-së, sidomos të atyre mbi qendrat jopublike komunitare të shërbimeve shoqërore, me të dhënat e donatorëve apo të disa bashkive të vendit, si për shembull të Bashkisë Tiranë, e shkaktuar nga:

- Organizimi i shërbimeve shoqërore nga disa ofrues, publikë dhe jopublikë.
- Vështirësia për të përkufizuar llojin e shërbimit, për shkak të ofrimit të disa llojeve të shërbimeve në të njëjtën qendër, si rrjedhojë e nevojës të lartë për shërbime shoqërore.

3

LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE

Tabela 1: Qendrat e shërbimeve shoqërore sipas llojit	14
Tabela 2: Bashkitë e grupuara sipas numrit të shërbimeve që ofrojnë	18
Tabela 3: Bashkitë që nuk ofrojnë asnjë shërbim shoqëror, të grupuara sipas popullsisë	18
Tabela 4: Shërbimet shoqërore sipas tipologjisë dhe grupeve në nevojë	20
Tabela 5: Krahasimi i numrit mesatar të përfituesve të shërbimeve shoqërore në çdo qark me nivelin mesatar të përfituesve në nivel kombëtar, sipas qarqeve	27
Tabela 6: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Tiranë	30
Tabela 7: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Durrës	33
Tabela 8: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Gjirokastrë	35
Tabela 9: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Lezhë	38
Tabela 10: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Berat	40
Tabela 11: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Dibër	43
Tabela 12: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Elbasan	45
Tabela 13: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Kukës	47
Tabela 14: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Korçë	49
Tabela 15: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Vlorë	51
Tabela 16: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Fier	54
Tabela 17: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Shkodër	56
Tabela 18: Vlerësimi i nevojës për shërbime shoqërore	63
Tabela 19: Vlerësimi i nevojës për shërbime shoqërore	64
Figura 1: Qendra të shërbimeve sociale	15
Figura 2: Qendrat e shërbimeve sociale sipas llojit, në përqindje	15
Figura 3: Shërbimet shoqërore sipas llojit, në përqindje, 2018	16
Figura 4: Shpërndarja e shërbimeve shoqërore sipas qarqeve, në përqindje	16
Figura 5: Shpërndarja e shërbimeve shoqërore sipas grupeve dhe qarqeve, numër shërbimesh	17
Figura 6: Bashkitë, në të cilat ofrohen të gjitha shërbimet shoqërore	19
Figura 7: Shërbimet shoqërore të ofruara si edhe grupet përfituese, sipas ligjit dhe faktike	21
Figura 8: Përfituesit e shërbimeve shoqërore në përqindje, sipas qarqeve	22
Figura 9: Përfituesit e shërbimeve shoqërore sipas qarqeve dhe llojeve të shërbimeve	23
Figura 10: Përfituesit e shërbimeve shoqërore në bashki, sipas llojeve të shërbimeve, në përqindje	23
Figura 11: Përfituesit e shërbimeve shoqërore, të moshuar dhe fëmijë, sipas qarqeve	26
Figura 12: Përfituesit e shërbimeve shoqërore, individë me AK, Gra në nevojë kritike si dhe individë në nevojë, sipas qarqeve, 2018	26

Figura 13: Numri mesatar i banorëve për çdo shërbim sipas qarqeve	27
Figura 14: Përfituesit e shërbimeve shoqërore në përqindje, sipas grup-popullsisë dhe qarqeve	28
Figura 15: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Tiranë	31
Figura 16: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Tiranë	31
Figura 17: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Tiranë	32
Figura 18: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Durrës	33
Figura 19: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Durrës	34
Figura 20: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Durrës	34
Figura 21: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Gjirokastrë	36
Figura 22: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Gjirokastrë	36
Figura 23: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Gjirokastrë	37
Figura 24: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Lezhë	38
Figura 25: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Lezhë	39
Figura 26: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Lezhë	39
Figura 27: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Berat	41
Figura 28: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Berat	41
Figura 29: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Berat	42
Figura 30: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Dibër	43
Figura 31: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Dibër	44
Figura 32: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Dibër	44
Figura 33: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Elbasan	46
Figura 34: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Elbasan	46
Figura 35: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Kukës	48
Figura 36: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Korçë	49
Figura 37: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Korçë	50
Figura 38: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Korçë	50
Figura 39: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Vlorë	52
Figura 40: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Vlorë	52
Figura 41: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Vlorë	53
Figura 42: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Fier	54
Figura 43: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Fier	55
Figura 44: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Fier	55
Figura 45: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Shkodër	57
Figura 46: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Shkodër	57
Figura 47: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Shkodër	58

4

VLERËSIMI I NEVOJËS PËR SHËRBIME SHOQËRORE

VLERËSIMI I NEVOJËS PËR SHËRBIME SHOQËRORE NË KUADËR TË PROJEKTIT “ASKUSH TË MOS MBETET PAS” (LEAVE NO ONE BEHIND)

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm drejt krijimit të një shteti demokratik, funksionimit të ekonomisë së tregut, ruajtjes së një rritjeje të qëndrueshme ekonomike dhe arritjes së zhvillimit njerëzor. Megjithatë, zbatimi i politikave sociale për përfshirjen e grupeve vulnerabël, mbetet problematik. Për të mbështetur përmirësimin e përfshirjes sociale, agjencitë e OKB-së janë angazhuar në zbatimin e projektit “Askush të mos mbetet pas” (LNB), i cili synon që “Personat dhe grupet e përjashtuara apo në rrezik përjashtimi të kenë mundësi të barabarta për të përdorur shërbime shoqërore cilësore, gjë që do të mundësojë pjesëmarrjen në vendimmarrjen publike duke ndikuar në jetën e tyre”.

Në këtë kuadër, programi ofron ndihmë teknike për Shërbimin Social Shtetëror Shqiptar (SHSSH) - një institucion kombëtar, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), për të hartuar Raportin e Vlerësimit të Nevojave për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Shqipëri. Përgjegjësia e SHSSH-së për të vlerësuar dhe raportuar çdo vit mbi nevojat për shërbime të kujdesit social dhe kapacitetin e ofruesve të shërbimeve publike dhe jopublike është përcaktuar në ligjin për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë (neni 33, ligji nr. 121/2016).

Për të përmbushur këtë kërkesë të ligjit, në vitin 2018 SHSSH-ja u angazhua përmes DRShSh-ve në mbledhjen e të dhënave për vlerësimin dhe raportimin e nevojave për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri. Të dhënat e mbledhura ofrojnë informacion për shërbimet ekzistuese të kujdesit social në nivel rajonal, ofruesit e tyre (ofrues publikë ose jopublikë) si edhe shpërndarjen gjeografike dhe grupet përfituese.

Megjithatë, rezultoni e nevojshme që nevoja për shërbime shoqërore të vlerësohet edhe në perspektivën afatgjatë me qëllim që ShSSH/MHSP të udhëheqin politikatat dhe veprimet kombëtare dhe lokale në lidhje me shërbimet e kujdesit social. Në këtë kuadër, UNDP në përputhje me kërkesën e ShSSH, mbështet sigurimin e ekspertizës teknike për të ndërtuar një metodologji të vlerësimit të nevojave, analizës dhe raportimit të tyre, e cila do t'i shërbejë ShSSH-së për të:

- identifikuar mangësitë në ofrimin e këtyre shërbimeve në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar
- udhëhequr bashkitë në procesin e ndërtimit të planeve të zhvillimit shoqëror.
- ngritur dhe/ose zgjeruar shërbimet e kujdesit shoqëror për qytetarët në nevojë si edhe nxitjen e përfshirjes së tyre sociale.

5

SHËRBIMET SHOQËRORE/INSTRUMENT I PËRFSHIRJES SOCIALE TË GRUPEVE NË NEVOJË

Shqipëria ka identifikuar pjesëmarrjen e saj aktive në procesin Evropian të përfshirjes sociale si një nga angazhimet kryesore për anëtarësimin në BE – duke përfshirë zhvillimin dhe avancimin e politikave, kuadrin institucional dhe metodologjitë për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale të të gjithë qytetarëve dhe grupimeve sociale në Shqipëri.

Dokumenti politik i përfshirjes sociale, 2016-2020 synon krijimin e një kuadri të balancuar dhe të qëndrueshëm, për të siguruar që përfshirja sociale të matet, monitorohet dhe raportohet në Shqipëri përmes një grupi treguesish të përshtatshëm. Në këtë kontekst, ngritja, zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve shoqërore, mbështetur në nevojën e grupeve më të përjashtuara të shoqërisë, jo vetëm që realizon të drejtën e qytetarëve për të përfituar shërbime dinjitoze, por ndihmon zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe të kapitalit njerëzor e social.

Ligji 121/2016 “ Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjet mbi mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të grupeve të që gëzojnë mbrojtje të veçantë, si edhe vendimet përkatëse në zbatim të tyre dhe rregulloret e posaçme kanë ndihmuar në ngritjen e një kuadri të plotë ligjor.

Gjithashtu, reforma territoriale, nëpërmjet ligjit Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” përcakton përgjegjësitë e bashkive për:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve shoqërore, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehim social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve shoqërore vendore.
- Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ndonëse kuadri ligjor rezulton i plotësuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, për zbatimin e të cilave Shqipëria është përgjegjëse si rrjedhojë e detyrimeve kushtetuese e politike, realizimi i plotë i të drejtave të grupeve të përjashtuara cenohet nga mungesa e kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare e profesionale.

6

ANALIZA E SITUATËS SË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Analiza e situatës ekzistuese së shërbimeve shoqërore të ofruara në Shqipëri si dhe e grupeve që i përfitojnë këto shërbime, ndonëse në kushtet e informacionit të kufizuar, synon të ofrojë një përshkrim të qartë të situatës, sipas tre dimensioneve:

Dimensioni 1: Oferta e shërbimeve shoqërore.

Dimensioni 2: Kërkesa për shërbime shoqërore.

Dimensioni 3: Shpërndarja e diferencuar e shpërndarjes së shërbimeve.

Ndonëse është e pamundur të analizohen jashtë dhe në mënyrë të pavarur nga njeri tjetri, dimensionin 1 është analizuar kryesisht nëpërmjet informacionit dhe gjetjeve të paraqitura tek çështja 6.1; dimensionin 2 është analizuar kryesisht nëpërmjet informacionit dhe gjetjeve të paraqitura tek çështja 6.2; ndërsa dimensionin 3 është analizuar nëpërmjet informacionit dhe gjetjeve të paraqitura tek çështja 6.3.

Përgjatë përpunimit të informacionit të siguruar nga ShSSH dhe shpjegimit të tij, është sqaruar edhe metodologjia e përdorur.

6.1 Dimensioni 1 “Shërbimet shoqërore të ofruara në Shqipëri sipas qarqeve dhe bashkive” (Oferta e shërbimeve shoqërore)

Reforma e sistemit të kujdesit shoqëror ka qenë dhe vazhdon të jetë në vëmendjen e qeverisë. Ashtu si në vendet e tjera në tranzicion, edhe në Shqipëri, zhvillimi i shërbimeve shoqërore është udhëhequr nga tre parime thelbësore, të cilat janë përshkruar si reforma 3D (tre dimensionale), përkatësisht Deinstitutionalizimi që ka të bëjë me shpërbërjen e institucioneve rezidenciale dhe kalimin e kujdesit dhe shërbimeve nga institucione të mbyllura e të ofruara për një kohë relativisht të gjatë, në shërbime me bazë komunitare, të cilat janë me kosto më të ulët dhe më pranë nevojave të qytetarëve; Diversifikimi, që ka të bëjë me promovimin e modeleve të reja të sigurimit të shërbimeve shoqërore të integruara, nga ofrues qeveritarë dhe jo-qeveritarë; si dhe Decentralizimi, transferimi i të drejtave, detyrave dhe përgjegjësi sa më pranë pushtetit vendor, si një mënyrë për të afruar shërbimet tek qytetari.

Shërbimi Social Shtetëror si institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave, legjislacionin e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, e realizon misionin nëpërmjet:

- Administrimit të shërbimeve shoqërore për individët në nivel kombëtar;
- Programimit dhe detajimit të fondeve të ndihmës ekonomike;
- Programimit dhe detajimit të fondeve të pagesës për personat me aftësi të kufizuara;
- Programimit dhe detajimit të fondeve për shërbimet shoqërore;
- Kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe përdorimit të fondeve buxhetore për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuara dhe shërbimet shoqërore;
- Administrimit të Regjistrimit Elektronik Kombëtar për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- Monitorimit të standardeve të shërbimeve shoqërore në nivel kombëtar.

Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” përcakton shërbimet shoqërore që duhet të sigurohen me qëllim që çdo qytetar në Republikën e Shqipërisë, të realizojë të drejtat e tij të sigurisë dhe mbrojtjes sociale. Ndërsa në vijim (çështja 6.2) analizohen shërbimet sipas legjislacionit dhe sipas realizimit në praktikë, në këtë seksion shërbimet përshkruhen dhe analizohen vetëm sipas komponentit të shpërndarjes së tyre në territor, d.m.th. sipas qarqeve dhe bashkive. Vlen të sqarohet se analiza sipas qarqeve është përdorur për të lehtësuar formulimin e disa përfundimeve të mbështetura në tregues sasiorë dhe përshkruar, që i shërbejnë Shërbimit Social Shtetëror për të orientuar shpërndarjen e shërbimeve, kështu duke udhëhequr hartimin e politikave në nivel qendror. Për të plotësuar këtë komponent, është përdorur edhe analiza në nivel bashkie, nëpërmjet të njëjtëve tregues sasiorë dhe përshkruar, e cila shërben për të orientuar politikën sociale edhe në nivel lokal, duke konsideruar faktin që sipas ligjit 139/2015, bashkia është institucioni përgjegjës për ngritjen dhe administrimin e shërbimeve shoqërore për grupet në nevojë (neni 54, ligji 139/2015).

Shërbimi Social Shtetëror, mbledh dhe analizon të dhënat mbi ofruesit dhe përfituesit e shërbimeve shoqërore. Ky raport është mbështetur në informacionin e mbledhur dhe të kategorizuar nga ShSSH. Sistemi i përkujdesjes shoqërore ofron shërbime publike dhe jopublike për individë në nevojë në qendra rezidenciale dhe komunitare/ditore.

(i) Shërbimet shoqërore publike ofrohen në institucione rezidenciale dhe qendra ditore, të cilat financohen nga buxheti i shtetit. Në këto institucione ofrohen shërbime për fëmijë jashtë kujdesit prindëror e me probleme sociale, për persona me aftësi të kufizuara, të moshuar apo për viktime të trafikimit (gra, vajza, fëmijë dhe emigrantë) apo individë me nevojë të veçanta.

(ii) Shërbimet shoqërore jopublike ofrohen nga OJF-të. Këto shërbime që realizohen në komunitet janë të shpërndara kryesisht në qytetet e mëdha. Shërbimet komunitare financohen kryesisht nga donatorë të huaj.

Shërbimet shoqërore publike ofrohen në 30 qendra rezidenciale dhe 119 qendra komunitare/ditore, ndërsa shërbimet shoqërore jopublike ofrohen nga OJF ose organizata fetare në 86 qendra komunitare/ditore dhe 41 qendra rezidenciale; gjithsej në 276 qendra shërbimesh, të llojeve të ndryshme, siç e tregon edhe tabela 1.


Tabela 1: Qendrat e shërbimeve shoqërore sipas llojit.

Qarqet	Moshuar				Fëmijë				AK				Gra				Individë në nevojë			
	Rezidenciale		Komunitare		Rezidenciale		Komunitare		Rezidenciale		Komunitare		Rezidenciale		Komunitare		Rezidenciale		Komunitare	
	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP
1. Tiranë	2	5	7	0	2	4	4	29	1	0	4	15	2	2	5	0	0	0	3	0
2. Durrës	0	1	2	1	1	2	2	4	1	0	4	0	0	0	0	1	0	0	0	0
3. Gjirokastrë	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	1	0
4. Lezhë	0	0	1	0	0	3	1	0	0	0	1	1	0	1	0	0	0	0	8	2
5. Berat	1	0	2	1	0	0	0	1	2	0	2	1	0	0	0	0	1	0	0	3
6. Dibër	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	2	0
7. Elbasan	1	0	3	1	0	4	0	0	0	0	5	0	0	1	3	0	1	0	8	1
8. Kukës	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9. Korçë	0	1	4	2	1	2	0	1	1	0	2	2	0	2	0	0	0	0	5	3
10. Vlorë	0	0	2	0	2	0	1	0	1	0	1	2	1	0	0	3	0	0	1	2
11. Fier	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	1	1	0	1	0	0	2	4
12. Shkodër	1	4	1	0	3	2	1	4	1	4	6	0	0	1	1	0	1	0	16	0
Gjithsej 276	7	11	25	5	9	18	9	39	7	4	30	21	4	8	9	6	3	0	46	15
	P	32	JP	16	P	18	JP	57	P	37	JP	25	P	13	JP	14	P	49	JP	15
	R	18	K	30	R	27	K	48	R	11	K	51	R	12	K	15	R	3	K	61

Burimi: ShSSH, 2019

Siç edhe vlerësohet nga të dhënat e tabelës 1, si dhe figura 1, qendrat publike dominojnë ndaj atyre jopublike.


Figura 1: Qendra të shërbimeve sociale



Burimi: ShSSH, 2019

Qendrat komunitare gjithashtu dominojnë ndaj qendrave rezidenciale, siç edhe tregohet në figurën 2.


Figura 2: Qendrat e shërbimeve sociale sipas llojit, në përqindje



Burimi: ShSSH, 2019

Shërbimet shoqërore në Shqipëri ofrohen për pesë kategori kryesore: për të moshuar, për fëmijë, për individë me aftësi të kufizuara (AK), për gra në nevojë të veçantë si dhe individë të tjerë në nevojë. Figura 3 dëshmon se shërbimet për fëmijë zënë peshën kryesore në numrin e përgjithshëm të shërbimeve me rreth 27%. Shërbimet për individë me AK dhe ato për individë në nevojë zënë përkatësisht nga 25%, shërbimet për të moshuar rreth 18%, ndërsa shërbimet për gra në nevojë janë shumë të pakta, rreth 5% të numrit të përgjithshëm të shërbimeve.


Figura 3: Shërbimet shoqërore sipas grupeve, në përqindje, 2018



Burimi: ShSSH, 2018

Nëse analizojmë shpërndarjen e shërbimeve shoqërore sipas qarqeve, konstatojmë se ato thuajse janë të shpërndara në çdo qark të vendit, ndonëse siç edhe mund të justifikohet, rreth 31% e tyre janë të përqendruara në Tiranë (figura 4).

Figura 4: Shpërndarja e shërbimeve shoqërore sipas qarqeve, në përqindje




Burimi: ShSSH, 2018

Siç edhe mund të gjykojmë nga të dhënat e figurës 4, ekziston një diferencë e madhe edhe ndërmjet shërbimeve shoqërore të ofruara në qarqet e mëdha të vendit (Tirana: 31%, Durrësi: 7%). Gjithashtu konstatohet se shërbimet shoqërore në Qarkun e Fierit dhe Vlorës janë të pakta në numër, ndonëse janë qarqe të mëdha të vendit si nga sipërfaqja po ashtu edhe nga popullsia.

Figura 5 përforcon informacionet e figurës 4, duke ilustruar shpërndarjen e të gjitha shërbimeve shoqërore që ofrohen në Shqipëri, sipas qarqeve.

Figura 5: Shpërndarja e shërbimeve shoqërore sipas grupeve dhe qarqeve, në numër shërbimesh



Burimi: ShSSH, 2018

Analiza sipas qarqeve, sado e rëndësishme që të jetë, nuk lejon evidentimin e shpërndarjes së shërbimeve shoqërore tek qytetari, në komunitetin e tij. Për këtë qëllim, shpërndarja e shërbimeve shoqërore është analizuar edhe sipas bashkive, e para, për të kuptuar më qartë se cila është mundësia efektivisht reale e qytetarëve për të aksesuar shërbimet shoqërore, dhe e dyta, sepse bashkitë janë ligjërisht përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve shoqërore.

Analiza e shpërndarjes së shërbimeve shoqërore në nivel bashkie tregon se bashkitë mund të grupohen si vijon:

- Bashki që nuk ofrojnë asnjë shërbim shoqëror,
- Bashki që ofrojnë vetëm një lloj shërbimi,
- Bashki që ofrojnë dy deri katër lloje shërbimesh,
- Bashki që ofrojnë të gjitha llojet e shërbimeve (në këtë studim janë konsideruar pesë lloje shërbimesh, të cilat realisht ofrohen sot në Shqipëri, përkatësisht shërbime për të moshuar, për fëmijë jashtë kujdesit prindëror, për individë me aftësi të kufizuara, për gra në nevojë dhe për individë të tjerë në nevojë, sipas shpjegimit të dhënë tek pjesa “përkufizime dhe shkurtesa”).

Në këtë kategorizim janë konsideruar grupet që aktualisht përfitojnë shërbime shoqërore në Shqipëri, që janë:

- Të moshuarit,
- Fëmijët,
- Individët me aftësi të kufizuara,
- Gratë në nevojë,
- Individë të tjerë në nevojë.

Gjithashtu në analizë është përfshirë edhe grupi “Të pastrehë”. Por, meqenëse, programet e strehimit social kanë arritur të zbatohen me sukses vetëm në një numër të kufizuar të bashkive, kjo formë shërbimi, klasifikohet kryesisht si “shërbim monetar”, dhe ky grup nuk shfaqet në analizën e përgjithshme sipas bashkive.

Tabela 2 përmbledh të dhënat mbi grupimin e bashkive sipas numrit të shërbimeve që ofrojnë, duke i grupuar bashkitë në katër kategori.

Tabela 2: Bashkitë e grupuara sipas numrit të shërbimeve që ofrojnë

Bashki	Numri	Në përqindje
Nuk ofrojnë asnjë shërbim	21	34%
Ofrojnë vetëm një lloj shërbimi	14	23%
Ofrojnë dy deri në katër lloje shërbimesh	19	34%
Ofrojnë të gjitha shërbimet	7	9%
Gjithsej	61	100%

Burimi: ShSSH, 2019

Vetëm Bashkitë Tiranë, Korçë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Lezhë dhe Berat ofrojnë shërbime për të gjitha grupet në nevojë të renditura më lart.

Për të plotësuar kuadrin e analizës mbi mundësinë e qytetarëve për të përdorur shërbime shoqërore, le të analizojmë të dhënat e tabelës 3, e cila paraqet "Bashkitë që nuk ofrojnë asnjë shërbim shoqëror", të grupuara sipas "Popullsisë", përkatësisht:

- Bashki me popullsi deri 10 000 banorë.
- Bashki me popullsi 10 001 deri 20 000 banorë,
- Bashki me popullsi 20 001 deri 30 000 banorë,
- Bashki me popullsi mbi 30 000 banorë.

Tabela 3: Bashkitë që nuk ofrojnë asnjë shërbim shoqëror, të grupuara sipas popullsisë.

Bashki	Numri	Në përqindje
Bashki me popullsi deri 10 000 banorë	7	33%
Bashki me popullsi 10 001 deri 20 000 banorë	5	24%
Bashki me popullsi 20 001 deri 30 000 banorë	5	24%
Bashki me popullsi mbi 30 000 banorë	4	19%
Gjithsej	21	100%


Burimi: ShSSH, 2019

Analiza e thelluar edhe sipas llojeve të shërbimeve tregon se 38 bashki ose 62% e të gjitha bashkive të vendit nuk kanë shërbime për të moshuar, 43 bashki ose 71% e tyre nuk kanë shërbime për fëmijë, 37 bashki ose 61% e bashkive nuk ofrojnë shërbime për individë me aftësi të kufizuara dhe 39 bashki ose 64% e tyre nuk ofrojnë shërbime për individë në nevojë. Ajo që është jashtëzakonisht shqetësuese është fakti se nga bashkitë në të cilat mungojnë plotësisht shërbimet, bëjnë pjesë bashki me popullsi relativisht të konsiderueshme, mbi 25 000 banorë. Kështu, shërbimet për të moshuar dhe individë me AK mungojnë në 23% të bashkive me mbi 25 000 banorë, ndërsa shërbimet për fëmijë jashtë kujdesit prindëror, mungojnë në 31% të bashkive me mbi 25 000 banorë.

Vetëm në 7 bashki, ofrohen të gjitha shërbimet shoqërore (figura 6). Sidoqoftë, ashtu si edhe në rastin e analizës sipas qarqeve, shpërndarja gjeografike e shërbimeve është e rastësishme. Ajo nuk është e mbështetur në ndonjë studim kombëtar, mbi shpërndarjen e nevojave apo karakteristikave të tjera

demografike, ekonomike, sociale e kulturore. Kështu për shembull, në Bashkitë Berat dhe Lezhë, që kanë popullsi thujse të barabartë, numri i shërbimeve është shumë i ndryshëm. Ndërsa bashkia Durrës, popullsia e të cilës është thujse 2,5 herë më e lartë se sa e Lezhës, ka vetëm 2 shërbime më shumë se kjo e fundit.

Figura 6: Bashkitë në të cilat ofrohen të gjitha shërbimeve shoqërore



Burimi: ShSSH, 2019

Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” përcakton llojet e shërbimeve shoqërore që duhet të ofrohen në Shqipëri me qëllim plotësimin e nevojave të grupeve të përjashtuara ose në rrezik përjashtimi. Tabela 4 në boshtin horizontal paraqet shërbimet e përcaktuara në përputhje me ligjin, ndërsa në boshtin vertikal paraqiten grupet që kanë të drejtën të përfitojnë. Kuadratet e ngjyrosura tregojnë shërbimet shoqërore që aktualisht ofrohen si edhe grupet që i përfitojnë.

Tabela 4: Shërbimet shoqërore sipas tipologjisë dhe grupeve në nevojë.


Grupet përfituese sipas ligjit	Llojet e Shërbimeve sipas ligjit							
	Para/Përgatitore dhe këshillim	Shërbime që ofrohen nëpërmjet strukturave të specializuara				Politika të tjera të shërbimeve shoqërore		
		Komunitare Qendra ditore ose ½ ditore	Qendra për trajtim Emergjence/ Institucione të sistemit të drejtësisë	Rezidenciale (përfshirë strehëzat)	Shërbim në familje	Strehimi Social	Kujdesi alternativ për fëmijët jashtë kujdesit prindëror	Ri/integrim social
Familje në nevojë ekonomike e sociale								
Familje në nevojë për strehim						■		
Fëmijë		■		■			■	
Persona me aftësi të kufizuara (fëmijë dhe të rritur)		■		■	■			
Fëmijë në migrim								
Refugjatë			■					
Të rritur me probleme sociale			■					
Prindër të vetëm të fëmijëve të mitur								
Vajza shtatzënë								
Të mitur në konflikt me ligjin			■					
Të rinj në konflikt me ligjin			■					
Të moshuar në nevojë		■		■				

Burimi: ShSSH, 2019

Analiza e të dhënave të mbledhura nga ShSSH tregon se jo të gjitha shërbimet e përcaktuara në ligj, ofrohen në Shqipëri. Siç konfirmon tabela 4, për disa kategori të përjashtuara ose në rrezik përjashtimi, me përjashtim të ndihmës në para, nuk ofrohet asnjë shërbim tjetër. Kështu, për shembull familjet në nevojë ekonomike dhe sociale përfitojnë ndihmë ekonomike në para nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara në

legjislaconin përkatës, por nuk i sigurohen shërbime shoqërore të nevojshme për të siguruar riintegrimin e tyre në shoqëri. I njëjti vlerësim vlen edhe për grupin “prindër të vetëm të fëmijëve të mitur” si edhe për “Vajzat shtatzënë”.

Figura 7: Shërbimet shoqërore të ofruara si edhe grupet përfituese, sipas ligjit dhe faktike



Burimi: ShSSh,2019

Vlerësime përfundimtare në lidhje me ofertën e shërbimeve shoqërore:


- Shërbimet për fëmijë zënë peshën kryesore në numrin e përgjithshëm të shërbimeve, rreth 27%; Shërbimet për individë me AK dhe ato për individë në nevojë zënë përkatësisht nga 25%; Shërbimet për të moshuar rreth 18%, ndërsa shërbimet për gra në nevojë janë shumë të pakta, rreth 5% të numrit të përgjithshëm të shërbimeve.
- Qendrat jopublike sigurojnë rreth 60% të shërbimeve shoqërore, përkundrajt 40% të tyre që sigurohen nga qendrat publike, ndërsa qendrat komunitare/ditore sigurojnë rreth 65% të shërbimeve Shoqërore përkundrajt 35% që sigurohen nga qendrat rezidenciale.
- Rreth 31% e shërbimeve shoqërore janë të përqendruara në Qarkun e Tiranës, ndërsa numri më i vogël i shërbimeve (0,78%) ofrohet në Qarkun e Kukësit.
- 34% e bashkive të vendit (21 bashki) nuk ofrojnë asnjë shërbim. Nga këto, 43% janë bashki me popullsi mbi 20 000 banorë. Vetëm 7 bashki ose 9% e bashkive ofrojnë të gjitha shërbimet (vetëm ato që ofrohen sot në Shqipëri, d.m.th.: shërbime për të moshuar, për fëmijë jashtë kujdesit prindëror, për individë me aftësi të kufizuar, për gra në nevojë si edhe individë të tjerë në nevojë). 38 bashki ose 62% e të gjitha bashkive të vendit nuk kanë shërbime për të moshuar, 44 bashki ose 72% e tyre nuk kanë shërbime për fëmijë, 37 bashki ose 61% e bashkive nuk ofrojnë shërbime për individë me aftësi të kufizuara dhe 39 bashki ose 64% e tyre nuk ofrojnë shërbime për individë në nevojë.
- Analiza e Shërbimeve shoqërore sipas llojit, tregon se në Shqipëri ofrohen 5 lloje shërbimesh nga 8 lloje që përcakton ligji.

6.2 Dimensioni 2 “Përfituesit e shërbimeve shoqërore sipas qarqeve dhe bashkive” (Kërkesa për shërbime shoqërore)

Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” përcakton grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi, të cilët në përputhje me nevojën e tyre duhet të përfitojnë shërbimet përkatëse sociale e ri/integruese në Shqipëri. Tabelat 4 dhe figura 7 tregojnë se jo të gjitha grupet e përjashtuara mund të përdorin shërbime shoqërore. Vetëm 5 (ose 50%) nga 10 grupet e përcaktuara në ligj mund të përdorin shërbimet e destinuar për mbrojtjen dhe ri/integrimin shoqëror të tyre.

Duke iu referuar të dhënave të figurës 8, vlerësojmë se numri më i madh i përfituesve të shërbimeve shoqërore është në Qarkun e Tiranës (24%) siç edhe lehtësisht argumentohet nga numri relativisht i lartë i shërbimeve shoqërore në këtë bashki.

Figura 8: Përfituesit e shërbimeve shoqërore, në përqindje, sipas qarqeve




Burimi: ShSSH, 2019

Nga figura 8 konfirmohet se Fieri është qarku i dytë sipas përqindjes të përfituesve të shërbimeve shoqërore, gjë që është në kundërshtim me informacionin e siguruar nga figura 4. Gjithsesi, ky fakt mund të lidhet me pasaktësinë e të dhënave ose mund të tregojë për numrin e lartë të përfituesve për çdo institucion.

Shkodra, Elbasani dhe Durrësi kanë përkatësisht 11% të përfituesve, ndërsa Qarku Korçë, 10% të përfituesve. Qarqet e tjera kanë përqindje më të ulët të përfituesve të shërbimeve. Veçanërisht kritik është informacioni që përfitohet nga analiza e përfituesve të shërbimeve në qarkun e Vlorës, pesha specifike e të cilit është mjaft e ulët, rreth 6%.

Figura 9 ilustron përfituesit e shërbimeve shoqërore sipas llojeve të shërbimeve dhe qarqeve. Siç lehtësisht konstatohet në analizën sipas qarqeve, fëmijët janë përfituesit kryesorë të shërbimeve shoqërore në Shkodër, Durrës dhe Tiranë; të moshuarit dominojnë si kategori përfituese në Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë ndërsa individët me nevoja të veçantë janë përfituesit kryesorë të shërbimeve në Fier, Korçë, Elbasan, Lezhë dhe Berat. Ndonëse individët me aftësi të kufizuara janë përfitues të shërbimeve shoqërore në çdo qark të vendit, ata nuk janë grupi kryesor përfitues në asnjë qark.

Figura 9: Përfituesit e shërbimeve shoqërore sipas qarqeve dhe llojeve të shërbimeve




Burimi: ShSSH, 2019

Figura 10 paraqit përfituesit e shërbimeve shoqërore në bashkitë e vendit, sipas llojeve të shërbimeve, duke konfirmuar se “Individët në nevojë” përbëjnë grupin kryesor të përfituesve të shërbimeve me 27%, të pasuar nga “Fëmijët” me 19%, të “Moshuarit” me 17%, “Individët me AK” me 16% dhe “Gratë në nevojë” që janë grupi me peshën më të vogël me 13%.

Nëse i krahasojmë këto përfundime me të dhënat e figurës 3 konstatohet një “mospërputhje”, sepse Figura 3 dëshmon se shërbimet për fëmijë zënë peshën kryesore në numrin e përgjithshëm të shërbimeve, rreth 27%, të pasuara nga “Shërbimet për individë me AK” dhe ato për “Individë në nevojë” që zënë përkatësisht nga 25%. Në të vërtetë, nuk kemi të bëjmë me asnjë mospërputhje. Shërbimet për individë në nevojë sigurohen kryesisht nëpërmjet qendrave komunitare, ditore, të cilat lehtësojnë mundësinë e përdorimit, si dhe ofrohen me një kosto më të ulët. Ndërsa shërbimet për fëmijë, individë me AK ose të moshuar sigurohen kryesisht nëpërmjet qendrave rezidenciale, të cilat kanë kapacitet të kufizuar, sigurojnë shërbime më të specializuara si dhe me një kosto më të lartë.

Figura 10: Përfituesit e shërbimeve shoqërore në bashki, sipas llojeve të shërbimeve, në përqindje



Burimi: ShSSH, 2019

Sidoqoftë analiza e paraqitur tek 6.1 dhe 6.2 ndonëse hedh dritë mbi disa fakte që lidhen me aspektin sasior të përgjithshëm të shërbimeve, nuk ndihmon për të kuptuar se deri në cilin nivel plotësohet e drejta e qytetarëve për të përdorur shërbime shoqërore, pra nuk mundësojnë vlerësimin e “Kërkesës”.

Për të analizuar në mënyrë të plotë dhe të thellë “Kërkesën/Nevojën” për “Shërbime shoqërore” do të duhej të shfrytëzoheshin burime të tjera të të dhënave, të cilat ende nuk mblidhen plotësisht në Shqipëri. Hartimi i planeve sociale të bashkive do të ishte një burim i plotë dhe shumë i dobishëm për këtë qëllim. Por, meqenëse planet sociale nuk janë hartuar ende në të gjitha bashkitë e vendit, për të krijuar një ide të përgjithshme mbi mundësinë e qytetarëve për të përdorur shërbime shoqërore, në analizë u përdorën disa të dhëna “indirekte”.

Për të analizuar më thellë “Kërkesën” dhe për ta ilustruar atë, sidomos në drejtim të identifikimit të pabarazive në shpërndarjen e shërbimeve shoqërore, janë ndërtuar dy tregues thelbësorë:

- **Treguesi 1: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim;**
- **Treguesi 2: Pësha specifike e përfituesve të shërbimeve shoqërore në raport me grup-popullsinë”.**

Treguesi i parë është ndërtuar duke krahasuar numrin e shërbimeve sipas llojeve me popullsinë e secilit grup-përfitues, për të nxjerrë përfundime mbi numrin mesatar të banorëve për secilin shërbim. Kështu, nëse popullsia mbi 65 vjeç në një bashki është 15 000 banorë, ndërsa numri i institucioneve që ofrojnë shërbime për të moshuar, është 2, atëherë kufiri maksimal i përdorimit të shërbimeve është 15 000/2, d.m.th. 7500 banorë.

Sigurisht, ky tregues ndonëse shërben për të orientuar në mënyrë të krahasuar drejtimet e investimit në ngritjen e shërbimeve të reja shoqërore, nuk mund të konsiderohet i njëjtë me “Nevojën për shërbime”. Gjithashtu, ky tregues nuk mund të shërbejë për të llogaritur kostot e investimit apo të shërbimit, sepse pavarësisht rëndësisë së treguesve demografikë, nuk mund të konsiderohet i gjithë grupi “Të moshuar”, si grup në nevojë për shërbime shoqërore.

Një studim i thelluar do të evidentonte nëngrupet më kritike dhe secilin nën-grup, të vlerësuar sipas nevojave specifike. Por, në kushtet e mungesës së një informacioni të tillë, analiza është mbështetur në të dhënat ekzistuese.

Treguesi i “Numrit mesatar të fëmijëve” dhe i “Numrit mesatar të individëve me AK”, që përdorin shërbime shoqërore ka të njëjtin kuptim si treguesi i “Numrit mesatar të të moshuarve”. Gjithashtu, të tre këta tregues janë ndërtuar në të njëjtën mënyrë. Për të ndërtuar treguesin e numrit mesatar të individëve me AK që përdorin shërbime është marrë në konsideratë numri i individëve me AK në çdo qark, siç rezultojnë nga tabelat e ShSSH-së. Ndërsa për të ndërtuar treguesin e numrit mesatar të fëmijëve që përdorin shërbime shoqërore, është marrë në konsideratë numri i fëmijëve, sipas të dhënave demografike.

Informacioni që sjellin të dy treguesit, ashtu si dhe treguesi i “Numrit mesatar të të moshuarve”, është i kufizuar, për të njëjtat arsye të shpjeguara më lart: Jo të gjithë individët me aftësi të kufizuara kanë nevojë për shërbime specifike, dhe jo të gjithë fëmijët kanë nevojë për shërbime shoqërore. Megjithatë, pavarësisht kufizimeve, të tre treguesit i shërbejnë qëllimit tonë, vlerësimin të kërkesës.

Nga ana tjetër, metoda e përdorur, shërben për të llogaritur tregues mesatarë në nivel kombëtar, të cilët nëse konsiderohen si “vlera fillestare/baseline”, mund të përdoren nga Shërbimi Social Shtetëror për të orientuar politikën sociale të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel makro si edhe për të monitoruar progresin në të ardhmen.

Seksioni 6.3 në të cilin vlerësohen “Shpërndarja e diferencuar e shërbimeve shoqërore” plotëson informacionin në lidhje me “Kërkesën/Nevojën e krahasuar për shërbime shoqërore”.

Vlerësime përfundimtare në lidhje me kërkesën për shërbime shoqërore:

- Vetëm 5 (ose 50%) nga 10 grupet e përcaktuara në ligj mund të përdorin shërbimet e destinuar për mbrojtjen dhe ri/integrimin shoqëror të tyre.
- Numri më i madh i përfituesve të shërbimeve shoqërore është në Qarkun e Tiranës (24%), pasuar nga Qarku i Fierit, me 12%.
- Fëmijët janë përfituesit kryesorë të shërbimeve shoqërore në Qarqet Shkodër, Durrës dhe Tiranë; të moshuarit dominojnë si kategori përfituese në Qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë ndërsa individët me nevoja të veçanta janë përfituesit kryesorë të shërbimeve në Qarqet Fier, Korçë, Elbasan, Lezhë dhe Berat. Ndonëse individët me aftësi të kufizuara janë përfitues të shërbimeve shoqërore në çdo qark të vendit, ata nuk janë grupi kryesor përfitues në asnjë qark.
- Pamjaftueshmëria e informacionit të dhënë në aspektin cilësor, kufizon mundësinë e analizës së “Kërkesës/Nevojës” për shërbime shoqërore, e cila deri diku plotësohet nëpërmjet ndërtimit të dy treguesve thelbësorë dhe indirektë si “Numri mesatar i banorëve për çdo shërbim” dhe “Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve shoqërore në raport me grup-popullsinë”.

6.3 Dimensionimi 3 “Shpërndarja e diferencuar e shërbimeve shoqërore”


Përpunimi i thelluar i të dhënave të secilit qark dhe bashkive të secilit qark, shërben për të identifikuar situata tejet kritike, që dëshmojnë për mundësinë shumë të kufizuar të qytetarëve për të përdorur shërbime të ndryshme shoqërore, sipas nevojës së tyre, si edhe grupet e qytetarëve, të cilët nuk kanë asnjë mundësi që të përdorin shërbime shoqërore, si shërbimet e ofruara nga institucione publike, po ashtu edhe ato të siguruar nga ofruarës jopublikë.

Këtij qëllimi i shërben analiza e paraqitur në këtë seksion, e cila synon të evidentojë shpërndarjen e diferencuar të shërbimeve shoqërore, ndërmjet qarqeve dhe bashkive, duke u mbështetur në analizën e thelluar të dy treguesve, të ndërtuar për qëllimin e këtij vlerësimi, siç edhe u përshkrua në seksionin 6.2, përkatësisht “Numri mesatar i banorëve për çdo shërbim” dhe “Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve shoqërore në raport me grup-popullsinë”.

Kjo risi, që shërben për të thelluar vlerësimin e “Kërkesës” për shërbime shoqërore, i hap rrugën identifikimit të nevojave e për rrjedhojë, mund të udhëheqë investimet drejt plotësimit të nevojave më kritike, së paku në drejtim të reduktimit të pabarazive në shërbime, ndërmjet qarqeve të vendit.

Figura 11 paraqet përfituesit e shërbimeve shoqërore, përkatësisht të moshuarit dhe fëmijët, krahasuar me nivelin mesatar kombëtar të përfituesve për këto dy grupe. Nga kjo figurë, dallohet qartë se përveç Qarqeve Tiranë, Durrës, Shkodër e Korçë, në të gjitha qarqet e tjera, numri i përfituesve të shërbimeve të përmendura është nën nivelin mesatar.


Figura 11: Përfitues të shërbimeve sociale, të moshuarit dhe fëmijë, sipas qarqeve, 2018



Burimi: ShSSH, 2019

Figura 12, ilustron të njëjtën situatë por për tre grupet e tjera të përfituesve të shërbimeve shoqërore. Për këto 3 grupe, shpërndarja e shërbimeve paraqitet disi më proporcionale.


Figura 12: Përfitues të shërbimeve sociale, individë me AK, Gra në nevojë kritike si edhe individë në nevojë, sipas qarqeve, 2018



Burimi: ShSSH, 2019

Figura 13 pasqyron numrin mesatar të banorëve për çdo shërbim. Të dhënat e figurës tregojnë që mundësia e përdorimit të shërbimeve për të "Moshuar" është veçanërisht e vështirë në Qarkun e Fierit, për "Individë me AK" është e pamundur në Qarkun e Dibrës, ndërsa për "Fëmijë" është e pamundur në Qarkun e Kukësit dhe shumë e vështirë në Qarqet e Beratit, Lezhës, Gjirokastrës dhe Vlorës.

Figura 13: Numri mesatar i banorëve për çdo shërbim sipas qarqeve, 2018



Burimi: ShSSH, 2019

Megjithatë, për të krijuar ide të plotë të pabarazive ndërmjet qarqeve në lidhje me shpërndarjen e shërbimeve shoqërore, analizojmë të dhënat e përmbledhura krahasuese sipas qarqeve, të cilat evidentojnë diferencat ndërmjet numrit mesatar të grup-popullsisë për një shërbim dhe nivelit mesatar kombëtar (Tabela 5).

Tabela 5: Krahasimi i numrit mesatar të përfituesve të shërbimeve shoqërore në çdo qark me nivelin mesatar të përfituesve në nivel kombëtar, sipas qarqeve.

Qarqet	Numri mesatar i të moshuarve për një shërbim	Diferenca krahasuar me mesataren kombëtare	Numri mesatar i fëmijëve për një shërbim	Diferenca krahasuar me mesataren kombëtare	Numri mesatar i individëve me AK për një shërbim	Diferenca krahasuar me mesataren kombëtare
Tiranë	5479	4319	3851	7046	1372	1364
Durrës	7033	2765	6278	4619	1211	1525
Gjirokastrë	5719	4079	11 911	-1014	2561	176
Lezhë	15 239	-5441	14 721	-3824	3204	-468
Berat	5726	4072	27 791	-16 894	1394	1342
Dibër	6153	3645	0	10 897	0	2736
Elbasan	6033	3765	12 866	-1969	4462	-1726
Kukës	6792	3006	0	10 897	4978	-2242
Korçë	4415	5383	13 597	-2700	2646	90
Vlorë	12 171	-2373	33 107	-22 210	2434	302
Fier	37 453	-27 655	0	10 897	7664	-4928
Shkodër	5362	4436	6646	4251	908	1828
MK	9798		10 897		2736	

Burimi: ShSSH, 2019

Tabela 5 konfirmon qartësisht pabarazitë në shpërndarjen e shërbimeve shoqërore. Kështu, mundësia e qytetarëve të moshuar për të përfituar shërbime në Qarqet Lezhë, Vlorë dhe Fier është jashtëzakonisht e kufizuar; në Durrës, Dibër, Elbasan dhe Kukës është e kufizuar, ndërsa në Qarqet Tiranë, Gjirokastrë, Berat dhe Shkodër ekziston një mundësi më e moderuar. Më të favorizuarit duken të moshuarit e Korçës, të cilët kanë më shumë mundësi të përdorin shërbimet në qarkun e tyre.

Mundësia e fëmijëve në Qarqet e Dibrës, Fierit dhe Kukësit për të përfituar shërbime shoqërore, është tërësisht e mohuar, për shkak të mungesës së plotë të tyre; mundësia është tejet e kufizuar për fëmijët e


Qarqeve të Beratit dhe Vlorës, ndërsa për fëmijët e Qarqeve Gjirokastrër, Lezhë, Elbasan dhe Korçë, mundësia e përdorimit të shërbimeve është e kufizuar. Më të favorizuarit janë fëmijët e Tiranës, të cilët kanë më shumë mundësi të përdorin shërbimet në qarkun e tyre.

Individët me aftësi të kufizuara të Qarkut Dibër, nuk kanë asnjë mundësi që të përdorin shërbime shoqërore, fëmijët e Qarkut Fier kanë shumë pak mundësi që të përdorin shërbime shoqërore, fëmijët e Qarqeve Lezhë, Elbasan dhe Kukës kanë mundësi të kufizuara për të përdorur shërbime shoqërore, ndërsa për fëmijët e qarqeve të tjera është më e lehtë për të aksesuar shërbimet për të cilat kanë nevojë. Më të favorizuarit janë fëmijët e Gjirokastrës, Korçës dhe Vlorës, të cilët kanë më shumë mundësi të përdorin shërbimet në qarkun e tyre.

Me qëllim ndërtimin e kuadrit të plotë të analizës, shqyrtojmë edhe treguesin “Përfitues të shërbimeve shoqërore, në përqindje, sipas grup-popullsisë dhe qarqeve”, i cili është ndërtuar si raport i përfituesve të shërbimit në çdo qark, me grup-popullsinë (figura 14). Figura 14 dëshmon se pavarësisht numrit të shërbimeve apo kapacitetit të tyre, në çdo qark të vendit, pesha specifike e përfituesve në krahasim me kufirin maksimal të kërkesës, është thuajse e papërfillshme. Pesa specifike e të gjithë grupeve të përfituesve luhatet ndërmjet 0,01 dhe 1% të grup-popullsisë, për shumicën e qarqeve të vendit.

Ky tregues duhet pranuar me rezerva, për shkak të mënyrës me të cilën është llogaritur dhe që u shpjegua më lart. Megjithatë, edhe për grupin e “Individëve me AK”, për të cilët metodologjia e llogaritjes sjell informacion tepër të saktë e plotësisht të konsiderueshëm, sepse është llogaritur mbi numrin e individëve me AK, siç rezulton në regjistrat e ShSSH-së, si përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar ose kujdestarisë, ky tregues dëshmon se 0% (Dibër) deri në 3,5% (Durrës) e individëve me AK përfitojnë shërbime shoqërore (figura 14), gjë që konfirmon shpërndarjen e pabarabartë të shërbimeve shoqërore në Shqipëri.

Figura 14: Përfitues të shërbimeve shoqërore në përqindje, sipas grup popullsisë dhe qarqeve, 2018



Burimi: ShSSH, 2018

Vlerësime përfundimtare në lidhje me shpërndarjen e diferencuar të shërbimeve shoqërore:

- Ndërsa të moshuarit e Korçës, kanë më shumë mundësi të përdorin shërbimet në qarkun e tyre (Numri mesatar i të moshuarve për një shërbim është 4415), për të moshuarit në Qarqet Vlorë, Lezhë dhe Fier, kjo mundësi është tejte e kufizuar (Numri mesatar i të moshuarve për një shërbim është përkatësisht 12 171 në Vlorë, 15 239 në Lezhë dhe 37 453 në Fier).
- Mundësia e fëmijëve në Qarqet e Dibrës, Fierit dhe Kukësit për të përfituar shërbime shoqërore është tërësisht e mohuar, për shkak të mungesës së plotë të tyre, në dallim nga fëmijët e Tiranës, të cilët kanë shumë mundësi të përdorin shërbimet në qarkun e tyre (Numri mesatar i fëmijëve për një shërbim në Tiranë është 4319).
- Individët me aftësi të kufizuara të Qarkut Dibrë, nuk kanë asnjë mundësi që të përdorin shërbime shoqërore, në dallim nga fëmijët e Korçës, Gjirokastrës dhe Vlorës, të cilët kanë lehtësi në përdorimin e shërbimeve në qarqet e tyre (Numri mesatar i individëve me AK për çdo shërbim është përkatësisht në Korçë-90, në Gjirokastrë-176 dhe në Vlorë-302).
- Për shumicën e qarqeve të vendit, pesha specifike e të gjithë grupeve të përfituesve të shërbimeve shoqërore luhetet ndërmjet 0,01 dhe 1% të grup-popullsisë.
- Pabarazi të theksuara evidentohen në përfitimin e shërbimeve për individë me aftësi të kufizuara, përkatësisht nga 0% e individëve me AK në Qarkun e Dibrës, në 3,5% të individëve me AK në Qarkun e Durrësit.

7

VLERËSIM I NEVOJËS PËR SHËRBIME SHOQËRORE NË NIVEL BASHKIE

Me qëllim sigurimin e informacionit më të detajuar në nivel bashkie, në vijim paraqitet “Analiza e shërbimeve shoqërore në çdo bashki të vendit”, të grupuara sipas qarqeve, mbështetur vetëm në dy tregues, përkatësisht:

- **Treguesi 1:** Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim;
- **Treguesi 2:** Peshë specifike e përfituesve të shërbimeve shoqërore në raport me grup-popullsinë¹.

7.1 Bashkitë e Qarkut Tiranë

Qarku Tiranë, si qarku më i madh i vendit sipas treguesit të popullsisë, ofron shërbime shoqërore për 749 365 banorë, nga të cilët rreth 2/3 jetojnë në Bashkinë Tiranë (Tabela 6). Bashkia Kamëz, bashkia e dytë më e madhe e qarkut, ofron 1/10 e shërbimeve që ofron Bashkia Tiranë.

Tabela 6: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Tiranë¹


	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje									
	Nr.	%	Nr.	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Tiranë	557.422	74%	69	81%	10	71%	32	82%	19	95%	5	56%	3	100%
Kavajë	40.094	5%	3	4%	1	7%	1	3%	1	5%	0	0%		0%
Rrogozhinë	22.148	3%	3	4%	0	0%	0	0%	0	0%	3	33%		0%
Kamëz	104.190	14%	6	7%	1	7%	4	10%	0	0%	1	11%		0%
Vorë	25.511	3%	4	5%	2	14%	2	5%	0	0%	0	0%		0%
Gjithsej	749.365	100%	85	100%	14	100%	39	100%	20	100%	9	100%	3	100%

Burimi: ShSSH, 2018

Në dallim nga çdo qark i vendit, në Qarkun Tiranë shërbimet për fëmijë zënë një peshë të konsiderueshme specifike, rreth 50% (figura 15). Gjithsesi, kjo peshë e lartë i kushtohet kryesisht Bashkisë Tiranë, në të cilën funksionojnë 32 qendra shërbimesh rezidenciale dhe komunitare për fëmijë.

¹ Këtu janë përdorur edhe të dhëna të Raportit “Profili Social i Bashkive” (UNDP, 2017) si edhe “Shpenzimet për financimin e Shërbimeve Sociale në bashki” (UNDP, 2018).

Figura 15: Peshat specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Tiranë



Burimi: ShSSH, 2018

Ndonëse shërbime shoqërore ofrohen në çdo bashki të qarkut, vetëm në Tiranë ofrohen shërbime për të gjitha grupet në nevojë. Në Kamëz dhe Kavajë ofrohen për 3 nga 5 grupe, në Vorë për 2 nga 5 grupe, ndërsa në Rrogozhinë vetëm për një grup (Tabela 6).

Analiza sipas numrit mesatar të përfituesve për shërbim (treguesi 1, figura 16) dëshmon se:


Individët në nevojë pavarësisht nga lloji i nevojës, nuk mund të përfitojnë shërbime në Bashkinë Rrogozhinë.

Individët me AK në Bashkitë Kamëz dhe Vorë, nuk mund të përfitojnë shërbime në bashkinë e tyre, ndërsa në Bashkitë Tiranë dhe Kavajë ata kanë lehtësi në përdorimin e shërbimeve.

Fëmijët në Bashkitë Tiranë dhe Vorë kanë më shumë mundësi të përdorin shërbimet shoqërore se sa fëmijët në Bashkitë Kavajë dhe Kamëz.

Përveç Bashkisë Vorë, në të cilën të moshuarit kanë mundësi të përdorin shërbimet, në bashkitë e tjera të qarkut, mundësia e të moshuarve për të përdorur shërbime është tepër e kufizuar.


Figura 16: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Tiranë



Burimi: ShSSH, 2018

Ndërsa analiza sipas treguesit 2 (figura 17) konfirmon se në Qarkun e Tiranës pesha specifike e grupeve përfituese sipas grup-popullsisë luhetet ndërmjet 0,21 dhe 4,24%. Në Bashkinë Tiranë, ky tregues është ndërmjet 0,5 dhe 4,2%, çka tregon se shpërndarja e shërbimeve është e diferencuar.

Figura 17: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Tiranë



Burimi: ShSSH, 2018

Përfundime:

1. Në dallim nga çdo qark i vendit, në Qarkun Tiranë, shërbimet për fëmijë zënë një peshë të konsiderueshme specifike, rreth 50%.
2. Gjithsesi, kjo peshë e lartë i kushtohet kryesisht Bashkisë Tiranë, në të cilën funksionojnë 32 qendra shërbimesh rezidenciale dhe komunitare për fëmijë.
3. Megjithatë, shërbimet për fëmijë, të llogaritura sipas numrit të banorëve, janë gjithashtu të larta edhe në Bashkinë Vorë, ku funksionojnë 2 qendra për fëmijë.
4. Individët në nevojë janë grupi që përfiton më shumë shërbime në Qarkun Tiranë. Pesha specifike e tyre në krahasim me grup-popullsinë është 3% për qarkun, krahasuar me 1,3% të individëve me aftësi të kufizuara, 0,6% të të moshuarve dhe 0,6% të fëmijëve.
5. Programet e strehimit social në Bashkinë Tiranë kanë arritur të plotësojnë kërkesën për strehim për 36,5% të aplikantëve.
6. Në Bashkinë Rrogozhinë nuk ofrohet asnjë shërbim shoqëror.

7.2 Bashkitë e Qarkut Durrës²

Qarku Durrës, qarku i katërt për nga popullsia, ofron shërbime shoqërore për 262 785 banorë, nga të cilët rreth 67% jetojnë në Bashkinë Durrës (Tabela 7). Bashkia Durrës ofron 78% të shërbimeve të qarkut, ndërsa Bashkia Krujë, bashkia e dytë më e madhe e qarkut, ofron 17% të shërbimeve të qarkut.


Tabela 7: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Durrës

	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, në numër dhe përqindje									
	Numër	%	Numër	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Durrës	175 110	67%	15	78%	3	75%	8	89%	3	60%	1	100%	0	0%
Shijak	27 861	11%	1	6%	0	0%	0	0%	1	20%	0	0%	0	0%
Krujë	59 814	23%	3	17%	1	25%	1	11%	1	20%	0	0%	0	0%
Gjithsej	262 785	100%	19	100%	4	100%	9	100%	5	100%	1	100%	0	0%

Burimi: ShSSH, 2018

Siç tregon edhe figura 18, vetëm 3 lloj shërbimesh nga 5 që ofrohen në Shqipëri, ofrohen në bashkitë e Qarkut Durrës, nga të cilat 45% janë shërbime për fëmijë.

Figura 18: Peshat specifike të shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Durrës



Burimi: ShSSH, 2018

Ndonëse shërbime shoqërore ofrohen në çdo bashki të qarkut, në Durrës ato ofrohen për katër grupe, në Krujë për 3 grupe, ndërsa në Shijak ofrohen shërbime vetëm për individë me AK (Tabela 7).


Analiza sipas numrit mesatar të përfituesve për shërbim (treguesi 1, figura 19) dëshmon se:

- Individët në nevojë, me përjashtim të atyre me AK, nuk mund të përfitojnë shërbime në Bashkinë Shijak.
- Individët me AK në Bashkinë Shijak dhe Krujë kanë më shumë mundësi që të përfitojnë shërbime në bashkitë e tyre, se sa individët me të njëjtën nevojë, në Bashkinë Durrës.
- Fëmijët në Bashkinë Krujë kanë më shumë mundësi të përdorin shërbimet shoqërore në krahasim me fëmijët në Durrës.

² Këtu janë përdorur edhe të dhëna të Raportit "Profil Social i Bashkive" (UNDP, 2017) si edhe "Shpenzimet për financimin e Shërbimeve Sociale në bashki" (UNDP, 2018).

- Të moshuarit si në Bashkinë Durrës, ashtu edhe në Bashkinë Krujë kanë thujse të njëjtën mundësi që të përdorin shërbime.


Figura 19: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Durrës



Burimi: ShSSH, 2018

Ndërsa analiza sipas treguesit 2 (figura 20) konfirmon se në Qarkun e Durrësit pesha specifike e grupeve përfituese sipas grup-popullsisë luhetet ndërmjet 0,37 dhe 4,77%. Në Bashkinë Durrës, ky tregues është ndërmjet 0,83 dhe 4,77%.

Figura 20: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Durrës



Burimi: ShSSH, 2018

Përfundime:

1. Vetëm 4 nga 5 shërbime ofrohen në Bashkinë Durrës përkatësisht shërbime për të moshuar, fëmijë, gra dhe individë me AK. Në Krujë ofrohen shërbime për tre grupe, përkatësisht për të moshuar, fëmijët dhe individë me AK, ndërsa në Shijak ofrohen shërbime vetëm për individë me AK,
2. Ndonëse shërbimet për fëmijë zënë rreth 50% të totalit, përfituesit “fëmijë” përbëjnë 35% të totalit të përfituesve.
3. Individët me AK janë grupi që përfiton më shumë shërbime në Qarkun Durrës, nëse krahasohet numri i përfituesve me grupin e popullsisë përkatëse. Pësha specifike e tyre në krahasim me grup-popullsinë është 3,5 për qarkun, krahasuar me 0,9% të fëmijëve dhe 1,1% të të moshuarve.
4. Programet e strehimit social në Bashkinë Durrës kanë arritur të plotësojnë kërkesën për strehim për 400 familje, por numri i aplikantëve nuk është i qartë. Në dy bashkitë e tjera ky program nuk është zbatuar ende.
5. Vetëm në Durrës ofrohen shërbime shoqërore për gratë, ndërsa në asnjë nga bashkitë e qarkut nuk ofrohen shërbime për individët në nevojë.

7.3 Bashkitë e Qarkut Gjirokastrë

Qarku Gjirokastrë, tejet i prekur nga emigracioni, përbëhet nga 7 bashki, të cilat ofrojnë shërbime për 71 471 banorë (Tabela 8). Bashkia Gjirokastrë ofron 67% të shërbimeve të qarkut, ndërsa Bashkia Memaliaj, bashkia e dytë më e madhe e qarkut dhe me popullsi sa 40% e popullsisë së Gjirokastrës, nuk ofron asnjë shërbim.


Tabela 8: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Gjirokastrë

	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje								
	Numër	%	Numër	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	Në nevojë	%
Gjirokastrë	28 673	40%	4	67%	1	50%	1	100%	1	50%	0	1	100%
Libohovë	3667	5%	0	17%	0	50%	0	0%	0	0%	0	0	0%
Dropull	3503	5%	0	0%	0	0%	0	0%	0	0%	0	0	0%
Tepelenë	8244	12%	1	17%	0	0%	0	0%	1	50%	0	0	0%
Memaliaj	10 657	15%	0	0%	0	0%	0	0%	0	0%	0	0	0%
Përmet	10 614	15%	0	0%	0	0%	0	0%	0	0%	0	0	0%
Këlcyrë	6113	9%	0	0%	0	0%	0	0%	0	0%	0	0	0%
Gjithsej	71 471	100%	5	100%	1	100%	1	100%	2	100%	0	1	100%

Burimi: ShSSH, 2018

Siç tregon edhe figura 21, vetëm 4 lloje shërbimesh, nga 5 shërbime që ofrohen gjithsej në Shqipëri, ofrohen në bashkitë e Qarkut Gjirokastrë, nga të cilat 33% janë shërbime për të moshuar dhe po aq shërbime për individë me AK.

Figura 21: Peshat specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Gjirokastrë




Burimi: ShSSH, 2018

Analiza sipas numrit mesatar të përfituesve për shërbim (treguesi 1, figura 22) dëshmon se:

- Individët me AK në Bashkinë Tepelenë kanë lehtësi në përdorimin e shërbimeve shoqërore. Gjithashtu edhe në Bashkinë Gjirokastrë, individët me AK kanë mundësi të përdorin shërbime shoqërore, ndërsa në bashkitë e tjera kjo mundësi nuk ekziston.
- Të moshuarit në Bashkinë Libohovë do të kishin mundësi të përdornin shërbime, nëse qendra do të vihej në funksionim.
- Fëmijët si edhe individët në nevojë, përveçse në Bashkinë Gjirokastrë, nuk mund të përfitojnë shërbime në bashki të tjera të qarkut.


Figura 22: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Gjirokastrë



Burimi: ShSSH, 2018

Ndërsa analiza sipas treguesit 2 (figura 23) konfirmon se në Qarkun e Gjirokastrës si edhe në vetë Bashkinë Gjirokastrër, pesha specifike e grupeve përfituese sipas grup-popullsisë luhatet ndërmjet 0,31 dhe 14,75%.

Figura 23: Peshat specifike të përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Gjirokastrër



Burimi: ShSSH, 2018

Përfundime:

1. Nga 7 bashkitë e qarkut, vetëm 3 ofrojnë shërbime shoqërore, përkatësisht Bashkitë Gjirokastrër, Tepelenë dhe Libohovë (kur qendra të vihet në funksionim). Bashkitë Përmet, Memaliaj, Dropull dhe Këlcyrë nuk ofrojnë asnjë shërbim.
2. Në Qarkun Gjirokastrër ofrohen 4 nga 5 shërbime shoqërore dhe vetëm në Bashkinë Gjirokastrër ofrohen të gjitha. Bashkia Tepelenë ofron vetëm shërbime për individë me AK, ndërsa Bashkia Libohovë do të ofrojë shërbime vetëm për të moshuar, atëherë kur qendra e sapo ndërtuar do të vihet në përdorim.
3. Veçanërisht kritike është situata në Memaliaj, e cila është bashkia e dytë më e madhe e qarkut, me numrin më të lartë të familjeve në ndihmë ekonomike, ndërsa shërbimet mungojnë tërësisht.
4. Gjithashtu, kritike është situata në Bashkinë Tepelenë, bashki me probleme sociale dhe ekonomike.
5. Bashkia Libohovë ka mundësi të ofrojë shërbime shoqërore të përshtatshme për të moshuar, por qendra duhet të vihet në funksionim.
6. Vetëm 14,8% e individëve në nevojë përfitojnë shërbime shoqërore në Bashkinë Gjirokastrër, ndërsa në bashkitë e tjera të qarkut, shërbime të tilla nuk ofrohen.
7. Programet e strehimit social nuk funksionojnë në asnjë nga bashkitë e Qarkut Gjirokastrër.

7.4 Bashkitë e Qarkut Lezhë

Qarku Lezhë përbëhet nga 3 bashki, të cilat ofrojnë shërbime për 134 027 banorë (Tabela 9). Bashkia Lezhë ofron 72% të shërbimeve të qarkut, ndërsa Bashkia Kurbin, bashkia e dytë më e madhe e qarkut dhe me popullsi sa 75% e popullsisë së Lezhës, ofron vetëm 6% të shërbimeve.


Tabela 9: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Lezhë

	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje									
	Numër	%	Numër	%	Të Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Lezhë	65 633	49%	13	72%	1	100%	2	50%	1	50%	1	100%	8	80%
Kurbin	46 291	35%	1	6%	0	0%	1	0%	0	0%	0	0%	0	0%
Mirditë	22 103	16%	4	22%	0	0%	1	50%	1	50%	0	0%	2	20%
Gjithsej	134 027	100%	18	100%	1	100%	4	100%	2	100%	1	100%	10	100%

Burimi: ShSSH, 2018

Siç tregon edhe figura 24, të gjitha llojet e shërbimeve ofrohen në bashkitë e Qarkut Lezhë, nga të cilat 67% janë shërbime për individë në nevojë.

Figura 24: Peshat specifike të shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Lezhë




Burimi: ShSSH, 2018

Analiza sipas numrit mesatar të përfituesve për shërbim (treguesi 1, figura 25) dëshmon se:

- Individët me AK dhe të moshuarit në Bashkinë Lezhë kanë mundësi të përdorin shërbime shoqërore në bashkinë e tyre, mundësi e cila nuk ekziston për këto grupe në dy bashkitë e tjera.
- Fëmijët në Bashkinë Mirditë kanë shumë më tepër mundësi se sa fëmijët në Bashkinë Lezhë dhe akoma më shumë mundësi se sa fëmijët në Bashkinë Kurbin, për të përdorur shërbime në bashkitë e tyre.


Figura 25: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Lezhë



Burimi: ShSSH, 2018

Ndërsa analiza sipas treguesit 2 (figura 26) konfirmon se në Qarkun e Lezhës, pesha specifike e grupeve përfituese sipas grup-popullsisë luhatet ndërmjet 0,1 dhe 38,8%. Ky diferencim i thellë është rrjedhojë e numrit të madh të përfituesve të shërbimit të strehimit social si në Bashkinë Lezhë, ashtu edhe në Bashkinë Kurbin.

Figura 26: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Lezhë



Burimi: ShSSH, 2018

Përfundime:

1. Në Bashkinë Lezhë ofrohen të gjitha shërbimet shoqërore, në Bashkinë Mirditë vetëm 3 nga 5 shërbime, përkatësisht për “Fëmijë”, “Individë me AK” dhe “Në nevojë”, ndërsa në Kurbin ofrohet vetëm një lloj shërbimi, shërbim për fëmijë jashtë kujdesit prindëror.
2. Megjithatë, numri i përfituesve është i ulët sepse kapacitetet e shërbimeve janë të kufizuara, sidomos kapacitetet e shërbimeve për fëmijë dhe të moshuar.
3. Në Bashkitë e Lezhës dhe të Kurbinit, rreth 1/3 e të pastrehëve kanë përfituar mbështetje nëpërmjet strehimit social.
4. Bashkia Mirditë trajton me NE thujse 1/4 e popullsisë.
5. Në përgjithësi, numri mesatar i banorëve për çdo shërbim si dhe përqindja e përfituesve në çdo bashki, edhe atje ku këto shërbime ofrohen, është shumë e ulët.

7.5 Bashkitë e Qarkut Berat

Qarku Berat përbëhet nga 5 bashki, të cilat ofrojnë shërbime për 141 944 banorë (Tabela 10). Bashkia Berat ofron 4 lloje shërbimesh ose 60% të shërbimeve të qarkut, ndërsa Bashkia Kuçovë, popullsia e të cilës është sa 1/2 e Beratit, ofron shërbime sa 1/5 e shërbimeve të ofruara në Bashkinë Berat. Bashkitë Skrapar dhe Ura Vajguore, ndonëse me popullsi të konsiderueshme, sidomos Bashkia Ura Vajguore, ofrojnë shërbime përkatësisht vetëm për “Individë me AK” dhe “Në nevojë”.


Tabela 10: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Berat

	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje									
	Numër	%	Numër	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Berat	60 031	42%	8	63%	3	75%	1	100%	3	60%			1	25%
Kuçovë	31 262	22%	2	13%	0				1	20%			1	25%
Poliçan	10 953	8%	2	13%	1	25%			0				1	25%
Skrapar	12 403	9%	1	6%	0				1	20%				
Ura Vajguore	27 295	19%	1	6%	0				0				1	25%
Gjithsej	141 944	100%	14	100%	4	100%	1	100%	5	100%	0		4	100%

Burimi: ShSSH, 2018

Siç tregon figura 27, 43% e shërbimeve të ofruara janë shërbime për “Individë me AK”, ndërsa shërbimet për “Fëmijë” përbëjnë 7% të totalit.

Figura 27: Peshat specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Berat




Burimi: ShSSH, 2018

Analiza sipas numrit mesatar të përfituesve për shërbim (treguesi 1, figura 28) dëshmon se:

- Individët me AK në Bashkitë Berat dhe Skrapar kanë mundësi të përdorin shërbime shoqërore në bashkitë e tyre, mundësi e cila është e kufizuar për banorët e Kuçovës, ndërsa nuk ekziston për banorët e Poliçanit dhe Urës Vajgurore.
- Fëmijët kanë mundësi, ndonëse të kufizuara, që të përdorin shërbime vetëm në Bashkinë Berat, mundësi kjo që nuk ekziston për fëmijët e bashkive të tjera.
- Të moshuarit kanë mundësi të përdorin shërbime vetëm në Bashkitë Berat dhe Poliçan ndonëse për të moshuarit e Bashkisë Berat kjo mundësi është më e kufizuar.


Figura 28: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Berat



Burimi: ShSSH, 2019

Ndërsa analiza sipas treguesit 2 (figura 29) konfirmon se në Qarkun e Beratit, peshat specifike e grupeve përfituese sipas grup-popullsisë luhatet ndërmjet 1,1 dhe 7,6%.

Figura 29: Peshat specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Berat



Burimi: ShSSH, 2018

Përfundime:

1. Në Bashkinë Berat ofrohen 4 nga 5 shërbimet e mundshme dhe mungojnë shërbimet për gratë në nevojë. Në Bashkitë Kuçovë dhe Poliçan ofrohen vetëm dy lloje shërbimesh, përkatësisht për "Individë me AK" dhe "Në nevojë", në Kuçovë dhe për të "Moshuar" dhe "Individë në nevojë", në Bashkinë Poliçan. Në Bashkitë Skrapar dhe Ura Vajgurore ofrohen shërbime përkatësisht vetëm për "Individë me AK" dhe "Individë në nevojë".
2. Bashkia Ura Vajgurore, ndonëse ka një qendër shërbimesh multifunktionale, nuk e ka vënë ende në përdorim.
3. Kritike është situata e të moshuarve, për të cilët ofrohen shërbime tepër të kufizuara vetëm në 2 bashki, për rrjedhojë vetëm 0,7% e të moshuarve të qarkut, përfitojnë shërbime.
4. Gjithashtu, kritike është edhe situata e fëmijëve në nevojë, për të cilët ofrohen disa shërbime vetëm në Bashkinë Berat.
5. Veçanërisht e vështirë konsiderohet situata ekonomike dhe sociale në Bashkinë Skrapar, e cila edhe pse ka një popullsi sa 1/5 e Bashkisë Berat, ka numër thuajse të njëjtë përfituesish të NE, ndërsa shërbimet shoqërore për individë në nevojë në këtë bashki, nuk ekzistojnë.
6. Vetëm 3% e individëve në nevojë përfitojnë shërbime shoqërore në Qarkun Berat, ndërsa në Bashkitë Ura Vajgurore dhe Skrapar, këto shërbime nuk ekzistojnë.
7. Në përgjithësi numri mesatar i banorëve për çdo shërbim si edhe përfituesit në përqindje në çdo bashki, edhe atje ku këto shërbime ofrohen, është shumë i ulët.
8. Programi i strehimit social funksionon vetëm në Bashkinë Kuçovë.

7.6 Bashkitë e Qarkut Dibër

Qarku Dibër përbëhet nga 4 bashki, të cilat ofrojnë shërbime për 137 047 banorë. Qarku i Dibrës është qarku më i varfër i vendit sa i takon ofrimin të shërbimeve shoqërore. Në të gjithë qarkun ofrohen vetëm dy lloje shërbimesh, përkatësisht për të "Moshuar" në Bashkitë Dibër dhe Mat si edhe për "Individë në nevojë" në Bashkinë Mat. Në Bashkitë Bulqizë dhe Klos nuk ofrohet asnjë lloj shërbimi (Tabela 11).


Tabela 11: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Dibër

	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje									
	Numër	%	Numër	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Dibër	61 619	45%	2	40%	1	50%	0		0		1	100%	0	
Mat	27 600	20%	3	60%	1	50%	0		0		0		2	100%
Bulqizë	31 210	23%	0		0		0		0		0		0	
Klos	16 618	12%	0		0		0		0		0		0	
Gjithsej	137 047	100%	5	100%	2	100%	0	0%	0	0%	1	100%	2	100%

Burimi: ShSSH, 2018

Siç tregon edhe figura 30, pesha specifike e dy llojeve të shërbimeve të ofruara në qark është e barabartë, nga 50%.

Figura 30: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Dibër




Burimi: ShSSH, 2018

Analiza sipas numrit mesatar të përfituesve për shërbim (treguesi 1, figura 31) dëshmon se:

- Vetëm të moshuarit dhe vetëm në Bashkitë Dibër dhe Mat mund të përdorin shërbime në bashkinë e tyre, ndonëse mundësia e të moshuarve për të përdorur shërbime në Bashkinë Dibër është më e kufizuar.
- Fëmijët dhe individët me AK nuk kanë asnjë mundësi të përdorin shërbime në bashkitë e tyre sepse këto shërbime nuk ekzistojnë.


Figura 31: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarkut Dibër



Burimi: ShSSH, 2018

Ndërsa analiza sipas treguesit 2 (figura 32) konfirmon se në Qarkun e Dibrës, pesha specifike e grupeve përfituese sipas grup-popullsisë luhatet ndërmjet 0,2 dhe 8,3%. Kjo e fundit i takon përfituesve të mbështetjes nëpërmjet programit të strehimit social.

Figura 32: Peshat specifike të përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Dibër



Burimi: ShSSH, 2018

Përfundime:

1. Nga 4 bashkitë e qarkut, vetëm 2 ofrojnë shërbime shoqërore të institucionalizuara, për të moshuarit, gratë dhe individët në nevojë.
2. Veçanërisht kritike është situata e përfituesve të ndihmës ekonomike në të gjitha bashkitë e qarkut (ndonëse të dhënat e Bulqizës mungojnë), për të cilët nuk ofrohet asnjë shërbim.
3. Shërbimet mungojnë për të gjitha grupet e tjera, ndonëse ekzistojnë raste të fëmijëve të shfrytëzuar apo grave të dhunuara.
4. Në Mat funksionojnë dy qendra komunitare për individë në nevojë por evidenca nuk pasqyron se sa është numri i përfituesve.
5. Programi i strehimit social ka siguruar mbështetje kryesisht në Bashkinë Klos, si edhe disa raste në Bashkinë Mat.
6. Qarku i Dibrës është qarku më i varfër i vendit sa i takon ofrimin të shërbimeve shoqërore. Në të gjithë qarkun ofrohen vetëm dy lloje shërbimesh, përkatësisht për të "Moshuar" në Bashkitë Dibër dhe Mat si edhe për "Individë në nevojë" në Bashkinë Mat. Në Bashkitë Bulqizë dhe Klos nuk ofrohet asnjë lloj shërbimi.

7.7 Bashkitë e Qarkut Elbasan

Qarku Elbasan, qarku i tretë i vendit për nga popullsia, përbëhet nga 7 bashki, të cilat ofrojnë shërbime për 295 827 banorë. Megjithatë, 82% e shërbimeve të qarkut ofrohen në Bashkinë Elbasan, ku banon 48% e popullsisë (Tabela 12). Ndonëse në qark ofrohen të gjitha shërbimet (5 llojet), në Bashkitë Gramsh, Belsh dhe Peqin nuk ofrohet asnjë shërbim.


Tabela 12: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Elbasan

	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje									
	Numër	%	Numër	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Elbasan	141 714	48%	23	82%	4	80%	3	80%	4	80%	4	100%	8	80%
Gramsh	24 231	8%	0		0		0		0		0		0	
Librazhd	31 892	11%	2	7%	1	20%	0		1	20%	0		0	
Peqin	26 136	9%	1	4%	0		0		0		0		1	10%
Cërrik	27 445	9%	2	7%	0		1	20%	0		0		1	10%
Belsh	19 503	6%	0		0		0		0		0		0	
Përrenjas	24 906	8%	0		0		0		0		0		0	
Gjithsej	295 827	100%	28	100%	5	100%	4	100%	5	100%	4	100%	10	100%

Burimi: ShSSH, 2018

Siç tregon figura 33, pesha specifike e shërbimeve për të moshuar është më e larta me 36% të totalit, ndërsa pesha specifike e shërbimeve për gratë në nevojë është më e ulëta me 11%.

Figura 33: Peshat specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Elbasan




Burimi: ShSSH, 2018

Analiza sipas numrit mesatar të përfituesve për shërbim (treguesi 1, figura 34) dëshmon se:

- Individët me AK dhe të moshuarit në Bashkitë Elbasan dhe Librazhd kanë mundësi të kufizuara të përdorin shërbimet në qarkun e tyre, ndërsa në bashkitë e tjera të qarkut, kjo mundësi nuk ekziston.
- Fëmijët kanë mundësi tejet të kufizuara që të përdorin shërbime në bashkitë e tyre në Elbasan dhe në Cërrik, ndërsa fëmijët e bashkive të tjera nuk kanë mundësi të përdorin shërbime.

Figura 34: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Elbasan



Burimi: ShSSH, 2018

Ndërsa analiza sipas treguesit 2 (figura 34) nuk mund të përdoret sepse mungojnë të dhënat mbi përfituesit e shërbimeve në Bashkinë Elbasan.

Përfundime:

1. Nga 7 bashkitë e qarkut, vetëm 4 ofrojnë shërbime shoqërore.
2. Shërbimet për individët në nevojë përbëjnë 36% të të gjithë shërbimeve të qarkut.
3. 80% e shërbimeve për individët në nevojë ofrohen në Bashkinë Elbasan.
4. Konstatohen pasaktësi me informacionin sepse numri i përfituesve të shërbimeve në Bashkinë Elbasan thuhet mungon, gjë që ndikon në pasaktësinë e informacionit për "Përfituesit e shërbimeve sipas grup-popullsisë (treguesi 2) në përqindje".

7.8 Bashkitë e Qarkut Kukës

Qarku Kukës përbëhet nga 3 bashki, të cilat ofrojnë shërbime për 85 292 banorë (Tabela 13).

Ndonëse është një qark në të cilin problemet ekonomike dhe sociale janë kritike, shërbimet shoqërore për grupet në nevojë janë tejet të kufizuara. Të vetmet shërbime ofrohen në Bashkinë Kukës dhe ato janë vetëm për të "Moshuar" dhe "Individë me AK". Në dy bashkitë e tjera, Tropojë dhe Has, nuk ofrohet asnjë shërbim.

Tabela 13: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Kukës


	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje									
	Numër	%	Numër	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Kukës	47 985	56%	2	100%	1	100%	0		1	100%	0		0	
Tropojë	20 517	24%	0		0		0		0		0		0	
Has	16 790	20%	0		0		0		0		0		0	
Gjithsej	85 292	100%	2	100%	1	100%	0	0%	1	100%	0	0%	0	0%

Burimi: ShSSH, 2018

Analiza sipas peshës specifike të shërbimeve nuk është efektive për shkak të numrit tepër të kufizuar të shërbimeve si edhe grupeve përfituese.

Analiza sipas numrit mesatar të përfituesve për shërbim (treguesi 1, figura 35) dëshmon se përveç individëve me AK dhe të moshuarve në Bashkinë Kukës, asnjë grup tjetër në nevojë nuk mund të përdorë shërbime shoqërore as në Kukës dhe as në dy bashkitë e tjera.

Figura 35: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Kukës



Burimi: ShSSH, 2018

Analiza sipas treguesit 2 nuk ka kuptim sepse ajo analizë shërben për të treguar shpërndarjen e diferencuar të shërbimeve, ndërsa në rastin e qarkut Kukës, edhe ato shërbime që ofrohen, janë të përqëndruara në Bashkinë Kukës.

Përfundime:

1. Nga 3 bashkitë e qarkut, vetëm në Kukës ofrohen shërbime shoqërore.
2. Edhe në Kukës, shërbimet ofrohen vetëm për të moshuar dhe individë me AK.
3. Ndonëse numri i përfituesve të NE është shumë i lartë, në të tre bashkitë nuk ofrohen shërbimet për individët.
4. Vetëm 1,3% e të moshuarve dhe 0,6 % e individëve me AK përfitojnë shërbime shoqërore.

7.9 Bashkitë e Qarkut Korçë

Qarku Korçë, qarku i katërt nga popullsia, përbëhet nga 6 bashki, të cilat ofrojnë shërbime për 220 357 banorë. Megjithatë, 76% e shërbimeve të qarkut ofrohen në Bashkinë Korçë, aty ku banon 34% e popullsisë (Tabela 14). Ndonëse në qark ofrohen të gjitha shërbimet (5 llojet), ato ofrohen vetëm në Bashkinë Korçë. Në Bashkitë Devoll, Maliq dhe Pustec nuk ofrohet asnjë shërbim. Në Pogradec, në të cilin jeton 28% e popullsisë, ofrohen 3 lloje shërbimesh, përkatësisht për të "Moshuar", "Individë në nevojë" si dhe "Individë me AK".


Tabela 14: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Korçë

	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje									
	Numër	%	Numër	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Korçë	75 994	34%	20	76%	6	86%	3	75%	3	60%	2	100%	6	75%
Devoll	26 716	12%	0		0		0		0				0	
Kolonjë	11 070	5%	1	4%	0		1	25%	0				0	
Pogradec	61 530	28%	5	20%	1	14%	0		2	40%			2	25%
Maliq	41 757	19%	0		0		0		0				0	
Pustec (Liqenas)	3 290	1.5%	0		0		0		0				0	
Gjithsej	220 357	100%	26	100%	7	100%	4	100%	5	100%	2	100%	8	100%

Burimi: ShSSH, 2018

Siç tregon figura 36, pesha specifike e shërbimeve për "Individë në nevojë" është më e larta, me 32%, ndërsa pesha specifike e shërbimeve për "Gratë në nevojë" është më e ulëta, me 8%.

Figura 36: Pesha specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Korçë




Burimi: ShSSH, 2018

Analiza sipas numrit mesatar të përfituesve për shërbim (treguesi 1, figura 37) dëshmon se:

- Fëmijët kanë më shumë mundësi të përdorin shërbime në bashkinë e tyre në Kolonjë, në krahasim me fëmijët e Bashkisë Korçë, ndërsa për fëmijët e bashkive të tjera, kjo mundësi nuk ekziston.
- Të moshuarit kanë më shumë mundësi të përdorin shërbime në bashkinë e tyre në Korçë, në krahasim me "të Moshuarit" e Bashkisë Pogradec, ndërsa për të moshuarit e bashkive të tjera, kjo mundësi nuk ekziston.
- Individët me AK kanë thuajse të njëjtat mundësi që të përdorin shërbime në bashkitë e tyre, në Korçë dhe Pogradec, ndërsa për individët me aftësi të kufizuara në bashkitë e tjera të qarkut, kjo mundësi nuk ekziston.


Figura 37: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Korçë



Burimi: ShSSH, 2018

Ndërsa analiza sipas treguesit 2 (figura 38) konfirmon se në Qarkun e Korçës, pesha specifike e grupeve përfituese sipas grup-popullsisë luhatet ndërmjet 0,28 dhe 6,4%.

Figura 38: Pesha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Korçë



Burimi: ShSSH, 2018

Përfundime:

1. Nga 6 bashkitë e qarkut, vetëm 3 ofrojnë shërbime shoqërore. Në Bashkitë Devoll, Maliq dhe Pustec nuk ofrohet asnjë shërbim.
2. Në qark ofrohen të gjitha llojet e shërbimeve, ndonëse 76% e tyre ofrohen në Bashkinë Korçë.
3. Individët me AK janë grupi që përfitojnë më shumë shërbime, 2,6% e tyre. 4.0,1% e fëmijëve përfitojnë shërbime shoqërore në bashkitë e Qarkut Korçë.

7.10 Bashkitë e Qarkut Vlorë

Qarku Vlorë përbëhet nga 7 bashki, të cilat ofrojnë shërbime për 175 640 banorë. Megjithatë, 55% e shërbimeve të qarkut ofrohen në Bashkinë Vlorë, në të cilën banon 60% e popullsisë (Tabela 15). Në përgjithësi shërbimet në këtë qark janë të kufizuara. Në 3 bashki nuk ofrohet asnjë shërbim. Në Bashkinë Vlorë, e cila është bashkia më e madhe e qarkut, ofrohen 3 lloje shërbimesh, për fëmijë, individë në nevojë si edhe për individë me AK.


Tabela 15: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Vlorë

	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje									
	Numër	%	Numër	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Vlorë	104 827	60%	8	50%	0		1	34%	2	50%	2	50%	3	100%
Selenicë	16 396	9%	0		0		0		0		0			
Himarë	7 818	4%	1	6%	1	50%	0		0		0			
Sarandë	20 227	12%	6	38%	1	50%	2	66%	2	50%	1	25%		
Konispol	8 245	5%	0		0		0		0		0			
Finiq	10 529	6%	1	6%	0		0		0		1	25%		
Delvinë	7 598	4%	0		0		0		0		0			
Gjithsej	175 640	100%	16	100%	2	100%	3	100%	4	100%	4	100%	3	100%

Burimi: ShSSH, 2018

Siç tregon figura 39, pesha specifike e shërbimeve për "Individë me AK" dhe "Gra në nevojë" është më e larta, me 25% të totalit, ndërsa pesha specifike e shërbimeve për "Të moshuar" është më e ulëta, me 13%.

Figura 39: Peshat specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Vlorë




Burimi: ShSSH, 2018

Analiza sipas numrit mesatar të përfituesve për shërbim (treguesi 1, figura 40) dëshmon se:

- Ndonëse shërbimet për fëmijë ofrohen në Bashkinë Vlorë, mundësia e tyre për të përdorur këto shërbime është tepër e kufizuar sepse kapaciteti i shërbimeve është i pamjaftueshëm.
- Fëmijët në bashki të tjera të qarkut, me përjashtim të Bashkisë Sarandë në të cilën mundësia e përdorimit të shërbimeve për fëmijë është e moderuar, nuk mund të përdorin shërbime sepse ato nuk ekzistojnë në bashkitë e tyre.
- Të moshuarit në Himarë dhe Sarandë kanë mundësi të përdorin shërbime në bashkitë e tyre, ndërsa të moshuarit në bashki të tjera nuk mund të përdorin shërbime.
- Individët me AK kanë lehtësi në përdorimin e shërbimeve në bashkinë e tyre në Sarandë, mundësi më të kufizuara në Bashkinë Vlorë, ndërsa në bashkitë e tjera, kjo mundësi nuk ekziston.


Figura 40: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Vlorë



Burimi: ShSSH, 2018

Ndërsa analiza sipas treguesit 2 (figura 41) konfirmon se në Qarkun e Vlorës ky tregues luhatet ndërmjet 0,09 dhe 3,69%. Diferenca relativisht e ngushtë, nuk tregon domosdoshmërisht se shpërndarja e shërbimeve është e barabartë. Kjo vlerë do të interpretohej në këtë mënyrë nëse shërbimet do të ishin të shumta dhe të larmishme. Diferenca e ngushtë i dedikohet më tepër nivelit të varfër të shërbimeve.

Figura 41: Pësha specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Vlorë



Burimi: ShSSH, 2018

Përfundime:

1. Nga 7 bashkitë e qarkut, vetëm 4 ofrojnë shërbime shoqërore.
2. Shërbimet në Qarkun Vlorë janë të kufizuara.
3. Në 3 bashki nuk ofrohet asnjë shërbim.
4. Në Bashkinë Vlorë, e cila është bashkia më e madhe e qarkut, ofrohen 3 lloje shërbimesh, përkatësisht për fëmijë, individë në nevojë dhe për individë me AK.
4. Individët me AK janë grupi që përfitojnë më shumë shërbime, 2,2% e tyre.
5. 0,1% e fëmijëve dhe 0,3% e të moshuarve përfitojnë shërbime shoqërore.

7.11 Bashkitë e Qarkut Fier

Qarku i Fierit, qarku i dytë më i madh i vendit, përbëhet nga 6 bashki, të cilat duhet të ofrojnë shërbime shoqërore për 310 331 banorë. Megjithatë, Qarku i Fierit është qarku me shërbimet më të pakta në numër dhe në tipologji. Ndonëse ofrohen katër lloje shërbimesh, përkatësisht për të "Moshuar", "Individë me AK", "Gra" si dhe "Individë në nevojë", kapaciteti i tyre është tejte i kufizuar. Bashkia Fier, në të cilën jeton rreth 40% e popullsisë së qarkut, ofron 60% të shërbimeve të të gjithë qarkut. Në Bashkitë Patos, Divjakë dhe Mallakastër nuk ofrohet asnjë shërbim (Tabela 16). Në asnjë nga bashkitë e qarkut nuk ofrohen shërbime për fëmijë.


Tabela 16: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Fier

	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje									
	Numër	%	Numër	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Fier	120 655	39%	6	50%	1	100%	0		1	50%	0		4	66%
Patos	22 959	7%	0		0		0		0		0		0	
Roskovec	21 742	7%	2	17%	0		0		0		1		1	17%
Lushnje	83 659	27%	3	23%	0		0		1	50%	1	100%	1	17%
Divjakë	34 254	11%	1		0		0		0		1		0	
Mallakastër	27 062	9%	0		0		0		0		0		0	
Gjithsej	310 331	100%	12	100%	1	100%	0	0%	2	100%	3	100%	6	100%

Burimi: ShSSH, 2018

Figura 42 ilustron peshën specifike të shërbimeve të ofruara në bashkitë e Qarkut Fier, shërbime të pakta në numër dhe të varfra në tipologji. Në këto shërbime dominojnë shërbimet për individët në nevojë.

Figura 42: Peshë specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Fier




Burimi: ShSSH, 2018

Figura 43 (analiza sipas treguesit 1) konfirmon se mundësia e qytetarëve në nevojë, përkatësisht e të moshuarve në Bashkinë Fier si dhe e individëve me AK në Bashkitë Fier dhe Lushnje, për të përfituar

shërbime në bashkitë e tyre, është tejet e kufizuar. Për grupe të tjera në nevojë, kjo mundësi nuk ekziston, pavarësisht nga bashkia në të cilën ata jetojnë.

Figura 43: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Fier




Burimi: ShSSH, 2018

Figura 44 ilustron peshën specifike të grup-përfituesve sipas grup-popullsisë, në përqindje (treguesi 2).

Ky tregues qëndron ndërmjet 0,33 dhe 3,28%. Ashtu si edhe në rastin e bashkive të Qarkut Vlorë, diferenca relativisht e ngushtë, nuk tregon domosdoshmërisht se shpërndarja e shërbimeve është e barabartë. Diferenca e ngushtë më tepër i dedikohet nivelit të varfër të shërbimeve.

Figura 44: Peshat specifike të përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Fier



Burimi: ShSSH, 2018

Përfundime:

1. Në Qarkun e Fierit ofrohen katër lloje shërbimesh, përkatësisht për të "Moshuar", "Gra", "Individë me AK" si dhe "Individë në nevojë".
2. Në dy nga 6 bashkitë e qarkut, përkatësisht në Bashkitë Patos dhe Mallakastër nuk ofrohet asnjë shërbim.
3. Shërbimet për fëmijë mungojnë krejtësisht në të gjitha bashkitë e qarkut, ndonëse është qarku i dytë më i madh i vendit.
4. Individët në nevojë përfitojnë shërbime shoqërore. Ky është edhe grupi më i konsideruar.
5. 33% e individëve në nevojë në Bashkinë e Fierit si edhe 10% e tyre në rang qarku, përfitojnë shërbime shoqërore.

7.12 Bashkitë e Qarkut Shkodër

Qarku i Shkodrës përbëhet nga 5 bashki, të cilat duhet të ofrojnë shërbime për 215 347 banorë. Në këtë qark ofrohen të gjitha llojet e shërbimeve në të gjitha bashkitë. Bashkia Shkodër, në të cilën jeton rreth 63% e popullsisë së qarkut, ofron 81% të shërbimeve të të gjithë qarkut (Tabela 17).


Tabela 17: Popullsia dhe shërbimet sipas bashkive, Qarku Shkodër

	Popullsia		Shërbimet		Grupet përfituese të shërbimeve, numër dhe përqindje									
	Numër	%	Numër	%	Moshuar	%	Fëmijë	%	AK	%	Gra	%	Në nevojë	%
Shkodër	135 612	63%	37	82%	5	83%	8	80%	9	82%	2	100%	13	76%
Malësi e Madhe	30 823	15%	1	2%	0		0		1	9%				
Vau Dejës	30 438	14%	3	7%	1	17%	0		1	9%			1	6%
Pukë	11 069	5%	1	2%	0		1	10%	0				1	6%
Fushë-Arrëz	7 405	3%	3	7%	0		1	10%	0				2	12%
Gjithsej	215 347	100%	45	100%	6	100%	10	100%	11	100%	2	100%	17	100%

Burimi: ShSSH, 2018

Figura 45 rikonfirmon të dhënat e tabelës 17, sipas të cilës shërbimet për individët në nevojë përbëjnë pjesën më të madhe të shërbimeve, me 40% të totalit, ndërsa shërbimet për gratë në nevojë, përbëjnë pjesën më të vogël, me vetëm 2%.

Figura 45: Peshë specifike e shërbimeve ndaj totalit, në përqindje, Qarku Shkodër



Burimi: ShSSH, 2018


Figura 46 që ilustron peshën specifike të shërbimeve të ofruara në bashkitë e Qarkut të Shkodrës (treguesi 1), konfirmon se:

Individët me AK kanë mundësi të përdorin shërbimet në Bashkitë Shkodër, Vau Dejës dhe Malësi e Madhe, ndërsa individët me AK që jetojnë në Bashkitë Pukë dhe Fushë-Arrëz nuk kanë mundësi të përdorin shërbime në bashkitë e tyre.

Të moshuarit kanë mundësi të kufizuara për të përdorur shërbimet në bashkitë e tyre në Shkodër dhe Vau Dejës, ndërsa nuk kanë asnjë mundësi në bashkitë e tjera.

Fëmijët kanë më shumë mundësi që të përfitojnë shërbime në Bashkinë e Fushë-Arrëzit, kanë më pak mundësi në Shkodër dhe nuk kanë asnjë mundësi në bashkitë e tjera.


Figura 46: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, Qarku Shkodër



Burimi: ShSSH, 2018

Figura 47 ilustron të dhënat e analizës sipas treguesit 2. Sipas të dhënave, ky tregues qëndron ndërmjet 0,2% (Individë në nevojë, Bashkia Vau Dejës) dhe 6.2% (Fëmijë, Bashkia Shkodër).

Figura 47: Peshat specifike e përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, Qarku Shkodër



Burimi: ShSSH, 2018

8

VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE

Ky raport, pasi analizoi të dhënat e prodhuara nga Shërbimi Social Shtetëror në lidhje me shërbimet shoqërore dhe grupet përfituese të tyre, si edhe në përputhje me metodologjinë teknike të përgatitur për këtë qëllim, vlerësoi shërbimet shoqërore ekzistuese, sipas tre dimensioneve thelbësorë:

Dimensionimi 1: Si paraqitet oferta e shërbimeve?

Dimensionimi 2: Si paraqitet kërkesa për shërbime shoqërore?

Dimensionimi 3: Cila është shpërndarja e shërbimeve shoqërore, sa proporcionale është ajo?

Pavarësisht kufizimeve, të cilat janë shpjeguar në pjesët përkatëse, analiza e thelluar e informacionit tregoi se:

8.1 Në lidhje me ofertën e shërbimeve shoqërore

Pavarësisht ligjit dhe akteve nënligjore, shërbimet shoqërore të ofruara janë të pakta në numër, të varfra në tipologji, të përqendruara kryesisht pranë bashkive të mëdha dhe ende larg nevojës së qytetarëve për shërbime cilësore.

Çështja e financimit si dhe qëndrueshmëria e shërbimeve, mbeten probleme thelbësore, ndërsa pesha specifike e pagesave monetare vazhdon të mbizotërojë në krahasim me shërbimet.

Analiza eidentoi qartësisht se si numri i shërbimeve të ofruara, po ashtu edhe numri i grupeve që përfitojnë shërbime, është shumë më i vogël se sa nevoja, e përcaktuar në ligj. Është e nevojshme të hulumtohet më thellë për të njohur arsyet se pse shërbimet shoqërore të ofruara nuk përputhen me shërbimet që duhet të ofrohen sipas ligjit.

Mënyra, thuajse e vetme, e ofrimit të shërbimeve për grupet përkatëse është nëpërmjet strukturave të specializuara siç janë qendrat rezidenciale, komunitare apo strehëzat. Ndonëse kjo formë trajtimi është e praktikuar në të gjitha sistemet e shërbimeve shoqërore, si në vende të zhvilluara ashtu edhe në vende në zhvillim si vendi ynë, strategjia bashkëkohore e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale kërkon harmonizim të shërbimeve të këshillimit dhe riintegritimit, me shërbimet që sigurohen aktualisht nëpërmjet qendrave përkatëse.

Është mjaft kritik vlerësimi se për të rinjtë dhe të miturit në konflikt me ligjin, përveç trajtimit në institucionet e specializuara të sistemit të drejtësisë, nuk ekziston asnjë formë tjetër mbrojtjeje apo riintegrimi social.

8.2 Në lidhje me shpërndarjen e diferencuar të shërbimeve shoqërore

I gjithë informacioni i ofruar dhe i analizuar këtu, tregoi qartësisht se shërbimet shoqërore janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë, duke diskriminuar popullsinë si dhe duke kufizuar të drejtën e qytetarëve për të përfituar shërbime në bashkitë e tyre. Diferencimet vihen re ndërmjet:

- Bashkive të mëdha dhe të vogla.
- Bashkive kryesisht urbane dhe rurale.
- Bashkive me të ardhura të konsiderueshme në krahasim me ato të zonave më të varfra të vendit.

Gjithashtu, pabarazitë thellohen për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet politikave sociale në nivel qendror dhe në nivel vendor. Ndonëse baza e të dhënave që ShSSH ka krijuar, është e pasur dhe ShSSH përpqet të rrisë efektivitetin e përdorimit të saj, orientimet e dhëna nga ShSSH nuk kanë gjetur ende zbatim në nivelin vendor.

Jo rrallë, njësitë e qeverisjes vendore financojnë ose mbështesin shërbime të cilat jo domosdoshmërisht përkojnë me nevojat prioritare të qytetarëve në nevojë, si dhe nuk janë të justifikuara nga analizat sociale dhe ekonomike të vetë bashkive.

8.3 Në lidhje me kërkesën për shërbime shoqërore

Mundësitë e qytetarëve për të përdorur shërbime janë të kufizuara sepse shërbimet nuk janë të shpërndara në të gjithë vendin dhe në përputhje me nevojën, ndërsa kapacitetet institucionale, infrastrukurore dhe financiare janë të kufizuara.

Analiza e paraqitur këtu, e vërtetoi në disa mënyra mundësinë e kufizuar të qytetarëve ose në disa raste edhe mundësinë e mohuar, nëpërmjet vlerësimit të peshës specifike të përfituesve të shërbimeve në raport me grup-popullsinë, si edhe numrin mesatar të qytetarëve përfitues për çdo shërbim.

9

REKOMANDIME

Mbështetur në qëllimin kryesor të këtij raporti, për të analizuar informacionin ekzistues dhe të dhënat administrative që pasqyrojnë shërbimet shoqërore në Shqipëri dhe përfituesit e tyre, me qëllim vlerësimin e nevojës për këto shërbime, për të orientuar procesin e hartimit të politikave efektive të kujdesit shoqëror në nivel qendror e lokal, e më tej, të politikave të përfshirjes sociale, si dhe në gjetjet e tij e të grupuara sipas tre dimensioneve të analizës, përkatësisht oferta, kërkesa dhe shpërndarja e diferencuar e shërbimeve, rekomandimet janë përqendruar në tre drejtime themelore:

Drejtimi 1: Rritja e efektivitetit të politikave ekzistuese të kujdesit shoqëror nëpërmjet monitorimit të shërbimeve shoqërore ekzistuese si dhe përmes zbatimit të standardeve të cilësisë së tyre, duke ndikuar në institucionalizimin e ofertës për shërbime shoqërore.

Drejtimi 2: Ndërtimi i një metodologjie të qëndrueshme dhe shkencore për të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nevojën për shërbime shoqërore, duke ndikuar në këtë mënyrë në institucionalizimin e vlerësimit të kërkesës/nevojës, e cila duhet të udhëheqë zhvillimin e ofertës.

Drejtimi 3: Propozimi i skemës teknike për vlerësimin e nevojës për shërbime shoqërore si dhe hapat për realizimin e saj mbështetur në misionin e ShSSH.

9.1 Në lidhje me përmirësimin e sistemit ekzistues të shërbimeve shoqërore

1. Legjislacioni ekzistues duhet të rishikohet dhe plotësohet sidomos në drejtim të krijimit të kushteve për ofrimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme si dhe të reflektimit të nevojave të reja sociale. Gjithashtu duhet të rishikohet edhe "Ligji mbi Statistikat" me qëllim që treguesit e nevojshëm për të vlerësuar nevojën për shërbime shoqërore, të jenë pjesë e sistemit administrativ të të dhënave.
2. Planet sociale, sipas metodologjisë të miratuar nga ShSSH duhet të përgatiten në të gjitha bashkitë e vendit.
3. Njësitë e vlerësimit të nevojave për shërbime duhet të ngrihen në çdo bashki të vendit.
4. Shërbimet shoqërore në përputhje me vlerësimin e nevojës duhet të ngrihen në çdo bashki, sidomos në ato bashki në të cilat nuk ofrohet asnjë shërbim shoqëror. Ndërsa për bashkitë në të cilat rezulton se mundësia e përdorimit të shërbimeve është tepër e kufizuar për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm, duhet të shihet mundësia e harmonizimit dhe e plotësimit të nevojës në bashkitë më të afërta.
5. Shërbimi social në nivel qarku duhet orientojë me përgjegjësi bashkitë në procesin e ngritjes së shërbimeve të reja.
6. Ndonëse informacioni mbi shërbimet shoqërore, i mbledhur dhe përpunuar nga ShSSH është i konsiderueshëm dhe i pasur, me qëllim rritjen e efektivitetit të tij, dhe sidomos për të gjykuar mbi nevojën për shërbime shoqërore në Shqipëri, ShSSH duhet të:
 - Formulohë dhe miratojë një listë treguesish statistikore të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë, të monitorueshëm dhe unikë për çdo bashki, çdo 6 muaj, të cilët përshkruajnë shërbimet sipas llojit, vendndodhjes, kapacitetit maksimal, numrit të klientëve, llojit të shërbimeve, financuesit të shërbimeve, burimeve të financimit, burimeve njerëzore si dhe kapaciteteve të tjera institucionale.

- Formulojë dhe miratojë një listë treguesish që evidentojnë aplikantët për shërbime dhe përfituesit e shërbimeve, çdo 6 muaj.
- Formulojë dhe miratojë një listë treguesish që pasqyrojnë buxhetet e shpenzuara për shërbimet shoqërore në nivel qendror dhe lokal, përbërjen e tyre sipas burimit të financimit si dhe sipas llojeve të shërbimeve.
- Formulojë dhe miratojë një listë treguesish të monitorueshëm, çdo 6 muaj, mbi shkallën e plotësimin të standardeve dhe nivelin e kënaqësisë së klientëve.
- Formulojë dhe miratojë një listë treguesish që evidentojnë grupet dhe individët që kanë nevojë për shërbime por nuk mund t'i plotësojnë ato për shkaqe të ndryshme, si edhe analizën e shkaqeve, çdo vit.
- Formulojë formatin unik të raportimit 6-mujor dhe vjetor mbi shërbimet shoqërore, shoqëruar me një manual shpjegues si dhe me ofrimin e programeve për rritjen e kapaciteteve të punonjësve vendorë si dhe të ShSSH-së dhe degëve rajonale, me qëllim rritjen e cilësisë së informacionit që i ofrohet ShSSH-së.
- Unifikimin e burimit të të dhënave, sidomos mbi popullsinë.

9.2 Ndërtimi i një metodologjie të qëndrueshme dhe shkencore për të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nevojën për shërbime shoqërore

Nisur nga analiza e paraqitur këtu si edhe me qëllim që të vlerësohet nevoja për shërbime shoqërore në përputhje me standardet teorike dhe kërkesat praktike, duhet të zbatohet një metodologji për vlerësimin e vazhdueshëm dhe afatgjatë të nevojës për shërbime shoqërore në nivel qendror e lokal, e cila si një instrument i dobishëm dhe praktik, të mundësojë mbledhjen, analizën dhe raportimin e të dhënave efektive mbi grupet në nevojë dhe nevojën e tyre për shërbime shoqërore, me qëllim harmonizimin dhe koordinimin e përpjekjeve për hartimin dhe zbatimin e politikave efektive të shërbimeve shoqërore në nivel qendror dhe lokal.

Në parim çështja themelore e kësaj metodologjie qëndron në dallimin ndërmjet dy koncepteve teorike thelbësore: duhet të vlerësohet "Nevoja" duke konsideruar vetëm shërbimet që ofrohen si dhe përfituesit e tyre apo për të matur nevojën duhet të konsiderohen të gjithë grupet që kanë nevojë për çdo lloj shërbimi social, si për ato që ofrohen aktualisht, edhe për "Shërbimet që duhet të ofrohen"?

Me qëllim krijimin dhe ofrimin e shërbimeve efektive, që plotësojnë nevojat e qytetarëve, sikundër e përcakton edhe legjislacioni, dokumenti politik i përfshirjes sociale si dhe udhëzuesi për hartimin e planeve sociale në nivel bashkie, vlerësimi i nevojës për shërbime shoqërore duhet të marrë në konsideratë shërbimet që ofrohen dhe përfituesit e tyre, si dhe ato grupe/individë që për arsye të ndryshme nuk arrijnë të plotësojnë nevojën e tyre për shërbime shoqërore cilësore.

Të dhënat e vëzhguara dhe analizuara si rrjedhojë e projektit "Profili Social i Bashkive", i mbështetur nga UNDP, në vitin 2017, treguan se:

- Gratë e vetme me fëmijë si dhe pensionistët e vetmuar janë më të përjashtuarit në Shqipëri, të ndjekur nga "individët me aftësi të kufizuar" si edhe "përfituesit e ndihmës ekonomike".
- Të rinjtë dhe gratë e papuna janë gjithashtu në kushte kritike përjashtimi.

- Të papunët e pakualifikuar dhe të pa/arsimuar janë më të përjashtuarit në tregun e punës, dhe ky është edhe shkaku themelor i varfërisë së tyre.
- Diskriminimi gjinor në tregun e punës është tejet kritik dhe arsyeja themelore për papunësinë e grave. Jo më pak i dukshëm është diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara si dhe i popullsisë Rome dhe Egjiptiane.

Grupet e përjashtuara, të renditura më lart, janë familje dhe grupe individësh, të cilët janë krejtësisht ose pjesërisht të përjashtuar nga e drejta për (a) punësim, (b) arsim, (c) shërbim shëndetësor të përshtatshëm, (d) strehim, (e) informim (f) mbrojtje ligjore (g) shërbime rehabilitimi e integrimi në qendra ditore, rezidenciale apo strehëza etj. Megjithatë, të dhënat aktuale të ShSSH-së nuk tregojnë nevojën reale për shërbime shoqërore.

Me qëllim që planet sociale të bashkive të adresojnë nevojat reale për shërbime shoqërore është e nevojshme që të njihen të gjitha shërbimet shoqërore për të cilat kanë nevojë grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi. Skema në vijim, nëse do të plotësohej me të dhëna, do të krijonte mundësinë e njohjes dhe vlerësimit të nevojës për këto shërbime.

Tabela 18: Vlerësimi i nevojës për shërbime shoqërore

Grupet më të përjashtuara sipas studimeve më të fundit	Nevojat për shërbime				
	Punësim	Arsim	Shërbim shëndetësor	Strehim	Rehabilitim dhe integrim
Gra të vetme me fëmijë në ngarkim					
Pensionistë të vetmuar					
Individë me aftësi të kufizuara					
Përfitues të NE					
Të rinj të papunë					
Gra të papuna					
Të papunë afatgjatë					

Plotësimi i tabelës 18 mund të konsiderohet si një pike fillestare premtuese për të arritur tek vlerësimi i përgjithshëm i nevojave për shërbime shoqërore, me hipotezën që të dhënat mbi aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike do të shërbejnë për të evidentuar edhe familjet/individët në nevojë kritike për shërbime shoqërore.

Sidoqoftë duhet të nënvizohet edhe domosdoshmëria e harmonizimit të grupeve në nevojë, të përcaktuara si të tilla nga legjislacioni, si dhe i grupeve në nevojë, të evidentuara si të tilla nga studimet. Për këtë qëllim, grupet në nevojë, të renditura në tabelën 19, duhet të nën kategorizohen, me qëllim që të kemi një pamje më të plotë dhe më të saktë.

Tabela 19: Vlerësimi i nevojës për shërbime shoqërore

Grupet më të përjashtuara	Nevojat për shërbime							
	Punësim	Arsim	Shërbim shëndetësor	Strehim	Rehabilitim dhe Integrim	Mbrojtje ligjore	Këshillim	Informim
Gra të vetme me fëmijë në ngarkim								
Pensionistë të vetmuar								
Individë me aftësi të kufizuara								
Përfitues të NE								
Përfitues të NE dhe me probleme sociale								
Fëmijë të familjeve në NE								
Individë me aftësi të kufizuara në familjet përfituese të NE.								
Të rinj të papunë								
Gra të papuna								
Të papunë afatgjatë								
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror								
Fëmijë që punojnë								
Fëmijë të dhunuar								
Fëmijë që kanë braktisur shkollën								
Fëmijë të ngjuar								
Gra të dhunuara								
Gra të trafikuar								
Fëmijë në konflikt me ligjin								
Të rinj në konflikt me ligjin								

9.3 ShSSH-planifikues, rregullator dhe udhëzues i krijimit, administrimit dhe shpërndarjes së shërbimeve shoqërore në bashki

Mbështetur në metodologjinë e përzgjedhur për të krijuar një instrument metodologjik, në shërbim të ShSSH-së dhe seksioneve të bashkive, në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur hapat që duhet të ndiqen, jo vetëm me qëllim që bashkitë të mundësojnë vlerësimin e nevojës për shërbime shoqërore, por që edhe ShSSH, përgjegjës për politikat kombëtare të kujdesit social, të jetë i aftë të udhëzojë njësitë e qeverisjes vendore drejt planifikimit strategjik dhe efektiv të nevojës së tyre për shërbime shoqërore.

Në këtë kontekst, gjykohet që çdo bashki duhet të institucionalizojë procesin e vlerësimit të nevojës, i cili duhet të përbëhet nga këto elementë:

Hapi 1: Vlerësimi i ofertës për shërbime, nëpërmjet treguesve që vijnë:

- Lloji i shërbimeve që ofrohen në bashki, mënyra e ofrimit, ofruesi si dhe shpërndarja gjeografike.
- Lloji i shërbimeve sipas grupeve përfituese, kapaciteti maksimal, numri i përfituesve, buxheti vjetor, kosto e shërbimeve.
- Burimet e financimit të secilit shërbim si edhe pesha specifike e secilit burim.
- Numri i punonjësve që kontribuojnë për të siguruar funksionimin e shërbimeve, shkalla e kualifikimit, kosto e burimeve njerëzore si dhe burimet e mbulimit të shpenzimeve.
- Shkalla e plotësimit të standardeve.
- Niveli i kënaqësisë së klientëve.
- Buxhetet e shpenzuara për shërbimet shoqërore në nivel qendror dhe lokal, përbërja e tyre sipas burimit të financimit dhe sipas llojeve të shërbimeve.

Hapi 2: Vlerësimi i kërkesës për shërbime shoqërore, nëpërmjet treguesve që vijnë:

- Grupet në nevojë, emërtimi, numri, përbërja si dhe shpërndarja gjeografike e tyre.
- Shërbimet për të cilat këto grupe kanë nevojë; cila pjesë e nevojës së tyre plotësohet aktualisht në bashki; sa është numri i aplikantëve për secilin shërbim dhe cila është shkalla e plotësimit të nevojës për secilin shërbim.

Hapi 3: Vlerësimi i mjedisit ku ofrohen shërbimet shoqërore, nëpërmjet treguesve që vijnë:

- Identifikimi i shërbimeve, të cilat edhe pse sipas legjislacionit duhet të ofrohen, në realitet nuk ofrohen në nivel lokal.
- Analiza e shkaqeve që kushtëzojnë mungesën e shërbimeve, vlerësimi i numrit të individëve, nevojat e të cilëve nuk plotësohen për shkak të mungesës të shërbimeve për të cilat ato kanë nevojë, kosto e këtyre shërbimeve nëse do të ofroheshin si dhe mundësitë/kapacitetet institucionale për të garantuar përfitimin e tyre nga qytetarët më në nevojë.
- Identifikimi i shërbimeve të reja, të cilat duhet të organizohen, administrohen dhe menaxhohen në nivel lokal, kosto e tyre dhe burimet e mbulimit.

- Identifikimi i ofruesve potencialë të shërbimeve shoqërore, klasifikimi sipas natyrës së organizatave dhe kapaciteteve si dhe vlerësimi i mundësive të tyre.

Hapi 4: Ndërtimi i matricës së kombinuar.

Hapi 5: Identifikimi i boshllëqeve.

Hapi 6: Hartimi i modeleve të tabelave që duhet të plotësohen si edhe përcaktimi i afateve të frekuencës së mbledhjes së të dhënave.

Hapi 7: Ndërtimi i skemës së raportimit, përpunimit, analizës dhe informimit të rezultateve.

SHTOJCË: HARTAT E SHËRBIMEVE PËR 12 QARQET

QARKU BERAT



Shërbime shoqërore për fëmijë

- ▶ Shërbime komunitare/ditore për fëmijë (1 qendër)



Shërbime shoqërore për të moshuar

- ▶ Shërbime rezidenciale për të moshuar (1 qendër)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për të moshuar (3 qendra)



Shërbime për persona me aftësi të kufizuara

- ▶ Shërbime rezidenciale për PAK (2 qendra)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për PAK (3 qendra)






Shërbime të tjera shoqërore (4 qendra)

QARKU DIBËR



Përmbledhje e shërbimeve (5 qendra)

-  **Shërbime shoqërore për të moshuar**
 - ▶ Shërbime komunitare/ditore për të moshuar (2 qendra)
-  **Shërbime shoqërore për gra të dhunuara/viktima trafikimi**
 - ▶ Shërbime komunitare/ditore (1 qendër)
-  **Shërbime të tjera shoqërore (2 qendra)**

QARKU DURRËS



Përmbledhje e shërbimeve (19 qendra)



Shërbime shoqërore për fëmijë

- ▶ Shërbime rezidenciale për fëmijë (3 qendra)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për fëmijë (6 qendra)



Shërbime shoqërore për të moshuar

- ▶ Shërbime rezidenciale për të moshuar (1 qendër)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për të moshuar (3 qendra)



Shërbime për persona me aftësi të kufizuara

- ▶ Shërbime rezidenciale për PAK (1 qendër)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për PAK (4 qendra)








Shërbime shoqërore për gra të dhunuara/viktima trafikimi

- ▶ Shërbime komunitare/ditore (1 qendër)


QARKU ELBASAN



Përmbledhje e shërbimeve (28 qendra)

-  **Shërbime shoqërore për fëmijë**
 - ▶ Shërbime rezidenciale për fëmijë (4 qendra)
-  **Shërbime shoqërore për të moshuar**
 - ▶ Shërbime rezidenciale për të moshuar (1 qendër)
 - ▶ Shërbime komunitare/ditore për të moshuar (4 qendra)
-  **Shërbime për persona me aftësi të kufizuara**
 - ▶ Shërbime komunitare/ditore për PAK (5 qendra)
-  **Shërbime shoqërore për gra të dhunuara/viktima trafikimi**
 - ▶ Shërbime rezidenciale (1 qendër)
 - ▶ Shërbime komunitare/ditore (3 qendra)
-  **Shërbime të tjera shoqërore (10 qendra)**

QARKU FIER



Përmbledhje e shërbimeve (12 qendra)



Shërbime shoqërore për të moshuar

- ▶ Shërbime rezidenciale për të moshuar (1 qendër)



Shërbime për persona me aftësi të kufizuara

- ▶ Shërbime komunitare/ditore për PAK (2 qendra)



Shërbime shoqërore për gra të dhunuara/viktima trafikimi

- ▶ Shërbime rezidenciale (2 qendra)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore (1 qendër)



Shërbime të tjera shoqërore (6 qendra)

QARKU GJIROKASTËR



Përmbledhje e shërbimeve (5 qendra)



Shërbime shoqërore për fëmijë

- ▶ Shërbime rezidenciale për fëmijë (1 qendër)



Shërbime shoqërore për të moshuar

- ▶ Shërbime rezidenciale për të moshuar (1 qendër)




Shërbime për persona me aftësi të kufizuara

- ▶ Shërbime komunitare/ditore për PAK (2 qendra)



Shërbime të tjera shoqërore (1 qendër)

QARKU KORÇË



Përmbledhje e shërbimeve (26 qendra)



Shërbime shoqërore për fëmijë

- ▶ Shërbime rezidenciale për fëmijë (3 qendra)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për fëmijë (1 qendër)



Shërbime shoqërore për të moshuar

- ▶ Shërbime rezidenciale për të moshuar (1 qendër)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për të moshuar (6 qendra)



Shërbime për persona me aftësi të kufizuara

- ▶ Shërbime rezidenciale për PAK (1 qendër)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për PAK (4 qendra)



Shërbime shoqërore për gra të dhunuara/viktima trafikimi

- ▶ Shërbime rezidenciale (2 qendra)



Shërbime të tjera shoqërore (8 qendra)

QARKU KUKËS



Përmbledhje e shërbimeve (2 qendra)



Shërbime shoqërore për të moshuar

- ▶ Shërbime komunitare për të moshuar (1 qendër)



Shërbime për persona me aftësi të kufizuara

- ▶ Shërbime komunitare për PAK (1 qendër)

QARKU LEZHË



Përmbledhje e shërbimeve (18 qendra)



Shërbime shoqërore për fëmijë

- ▶ Shërbime rezidenciale për fëmijë (3 qendra)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për fëmijë (1 qendër)



Shërbime shoqërore për të moshuar

- ▶ Shërbime komunitare/ditore për të moshuar (1 qendër)



Shërbime për persona me aftësi të kufizuara

- ▶ Shërbime komunitare/ditore për PAK (2 qendra)




Shërbime shoqërore për gra të dhunuara/viktima trafikimi

- ▶ Shërbime rezidenciale (1 qendër)



Shërbime të tjera shoqërore (10 qendra)

QARKU SHKODËR



Përmbledhje e shërbimeve (28 qendra)



Shërbime shoqërore për fëmijë

- ▶ Shërbime rezidenciale për fëmijë (5 qendra)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për fëmijë (5 qendra)



Shërbime shoqërore për të moshuar

- ▶ Shërbime rezidenciale për të moshuar (5 qendra)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për të moshuar (1 qendër)



Shërbime për persona me aftësi të kufizuara

- ▶ Shërbime komunitare/ditore për PAK (6 qendra)



Shërbime shoqërore për gra të dhunuara/viktima trafikimi

- ▶ Shërbime rezidenciale (1 qendër)
- ▶ Shërbime komunitare (1 qendër)



Shërbime të tjera shoqërore (17 qendra)

QARKU TIRANË



Shërbime shoqërore për fëmijë

- ▶ Shërbime rezidenciale për fëmijë (6 qendra)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për fëmijë (33 qendra)



Shërbime shoqërore për të moshuar

- ▶ Shërbime rezidenciale për të moshuar (7 qendra)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për të moshuar (7 qendra)



Shërbime për persona me aftësi të kufizuara

- ▶ Shërbime rezidenciale për PAK (1 qendër)
- ▶ Shërbime komunitare/ditore për PAK (19 qendra)



Shërbime shoqërore për gra të dhunuara/viktima trafikimi

- ▶ Shërbime rezidenciale (4 qendra)
- ▶ Shërbime komunitare (4 qendra)








Shërbime të tjera shoqërore (3 qendra)

QARKU VLORË



Përmbledhje e shërbimeve (28 qendra)

-  **Shërbime shoqërore për fëmijë**
 - ▶ Shërbime rezidenciale për fëmijë (2 qendra)
 - ▶ Shërbime komunitare/ditore për fëmijë (1 qendër)
-  **Shërbime shoqërore për të moshuar**
 - ▶ Shërbime komunitare për të moshuar (2 qendra)
-  **Shërbime për persona me aftësi të kufizuara**
 - ▶ Shërbime rezidenciale për PAK (1 qendër)
 - ▶ Shërbime komunitare për PAK (3 qendra)
-  **Shërbime shoqërore për gra të dhunuara/viktima trafikimi**
 - ▶ Shërbime rezidenciale (1 qendër)
 - ▶ Shërbime komunitare/ditore (3 qendra)
-  **Shërbime të tjera shoqërore (3 qendra)**

